[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | **VITI** IX - **NR.** 133 (2656) | **E SHTUNË**, 08-06-2019 | www.shqiptaria.com

INVESTIGIMI

JA SI 5 GJYQTARET E EMERUAR NGA PD LIRUAN ASTRIT AVDYLAJN

Gjykata e Lartë e kontrolluar nga të besuarit e Berishës nxorri nga burgu bosin e Shijakut me argumentin se: "Qelia i shkaktonte stres". Të 5 gjyqtarët u "dogjën" nga Vettingu



Edmond Islamaj



Shkëlzen Selimi





Tom Ndreca



Guxim Zenelaj



Tom Ndreca

DY MJEKET U AKUZUAN "EKSPERTIM TE RRREME" PER SHENDETIN MENDOR, POR GJYKATA U MBYLLI DOSJEN

ZBARDHET EKSPERTIMI PSIQIK PER AVDYLIN: I PAPARASHIKUESHEM, ME TENDENCA VETEVRASJE

NGA ELTON QYNO & ADRIATIK DOÇI
REDAKSIA INVESTIGATIVE

▶ FAQE 2-3

INTERVISTA NE REPORT TV

DAKO SHUAN MISTERIN DHE RREFEN ME KE KA FOLUR TE 'PERGJIMET'

Kreu i Bashkisë së Durrësit në "Repolitix": Nuk mbaj mend të kem folur ndonjëherë në celular me Avdylajn



▶ FAQE 5

NGA DENIS MINGA

KRIMET E RENDA

Prela: Nga 624 CD, prokurorët urdhëruan transkriptimin selektiv

Përgjimet e publikuara tek VOA i zbardhi prokurori Besim Hajdarmataj tre ditë pasi mori në dorë '339-ën'



▶ FAQE 4

KRIZA POLITIKE

▶ FAQE 7

Alarmi nga agjensitë partnere: Protesta e sotme do të jetë e dhunshme

Mendohet që me përshkallëzimin e dhunës nga opozita joparlamentare të synohet hapja e rrugës e një skenari hipotetik të shtyrjes së datës së zgjdhjeve nga Presidenti

INTERVISTA ME DREJTORIN

Bido: Nga Tirana në Shkozë, si do të jenë dy godinat e Arkivës

NGA DHURATA HAMZAI

▶ FAQE 13



PROJEKTLIGJI

SI DO TE PROCEDOHET ME MAKINAT DHE GOMONET NEN SEKUESTER

Nisma ligjore e qeverisë prek mjetet e bllokuara deri në fund të vitit 2016

▶ FAQE 10



KENDI I EKSPERTIT

PENSIONET E DIPLOMATEVE, SI PERFITOHEN DHE DOKUMENTAT

Fadil Kepi sqaron si përfitohen pensionet suplementare nga familjarët e diplomatëve dhe si llogariten

▶ FAQE 14

NGA VALBONA MHILLI

Cyan magenta yellow black

AUDIO-PERGJIMET

DOSJA 339/1
TIRANE

Nxorën të sëmurë psiqik Avdylin, dy mjekët psikologë u morën të pandehur

Mjekët bënë "ekspertim të rremë" për shëndetin mendor, por gjykata u mbylli dosjen. Ja si u lirua nga qelia Avdyli



NGA ELTON QYNO & ADRIATIK DOÇI
REDAKSIA INVESTIGATIVE

Astrit Avdyli, konsiderohet si një nga njerëzit kryesorë që fliste me kryetarin e Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako dhe funksionarë të tjerë të PS, duke shërbyer si ndërlidhës i zyrtarëve dhe vëllait të Astritit, Altin Avdyli, i arrestuar gjatë operacionit "Volvo 4". Astrit Avdyli është dënuar me 16 vite burgim nga gjykata e Durrësit për akuzën e "Vrasjes me dashje", në dëm të një qytetari në Durrës. Por ajo që ka ndodhur më pas, për sa i përket lirimit të këtij personi është fakti se Astrit Avdyli, ka përdorur të gjitha manovrat ligjore me qëllim daljen nga burgu. Avdyli dhe avokatët e tij në Tiranë dhe Durrës, kanë zgjedhur një manovër tipike të zakonshme që përdoret në sallat e gjyqeve, për të sjellë lirimin e parakohshëm të Avdylit nga qelia e burgut të Shën Kollit në Lezhë, duke pretenduar se Astrit Avdyli vuante nga rregullime mendore dhe vuante nga depresioni, duke pasur shenja të natyrës për të kryer vetëvrasje. Avokatët mbrojtës kanë siguruar disa raporte mjekësore dhe menjëherë kanë filluar të depozitojnë në gjykatë, kërkesat për lirimin me kusht të të "çmendurit" Astrit Avdyli nga burgu. Kërkesën e parë për lirim e ka kryer në vitin 2006 duke parashtruar para gjykatës së Lezhës dhe shkaqet e gjendjes shëndetësore, si çrregullime mendore duke i rrezikuar seriozisht jetën e tij. Kjo kërkesë e bërë në gjykatë, Astrit Avdylit i është pranuar me vendimin nr. 253, datë 30 tetor 2006 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, vendim i cili u bazua në ekspertimin psikik të hartuar nga dy ekspertët psikologë Latif Fjolla dhe Shkëlqim Korabi. Por pas këtij vendimi, prokuroria e Lezhës ka nisur hetim për dy mjekët psikiatër që kanë bërë ekspertimin mendor të Astrit Avdylit, ekspertim për të cilin prokuroria kishte dyshime se ishte kryer i rremë. Dosja e prokurorisë ndaj ekspertëve Latif Fjolla e Shkëlqim Korbi në lidhje me ekspertimin e bërë ndaj Avdylit, i akuzonte ata për kryerjen e veprës penale të "Ekspertimit të rremë". Por s'ka kaluar shumë dhe kjo dosje është pushuar, pasi në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, nuk provohej që dy mjekët e marrë të pandehur të kishin kryer veprën penale për të cilën ishin akuzuar. Nga ana tjetër menjëherë pas nisjes së hetimeve ndaj dy mjekëve psikiatër, vendimi është prishur dhe pasi çështja është kthyer për rishqyrtim, me vendimin objekt rekursi, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur sërish prishjen e tij. Shkaku për të cilin është prishur në Apel vendimi për lirimin e Astrit Avdylit herën e parë ka rënë, pasi procedimi penal i filluar ndaj dy ekspertëve që kishin bërë aktin e ekspertimit psiqik në gjykimin e zhvilluar në vitin 2006, është pushuar me arsyetimin se nuk provohet që ekspertët të kenë kryer veprën penale të "ekspertimit të rremë" në këtë rast. Gjykata e Apelit Shkodër ka caktuar ekspertë të tjerë dhe ka administruar akt të ri ekspertimi në vitin 2015 për shëndetin psiqik të Astrit Avdylit. Sipas këtij akti, nga qëndrimi në burg, kërkuesit i rrezikohet jeta. Ndërkohë me një akt-ekspertimi shtesë, të njëjtët ekspertë kanë konkluduar se me një trajtim adekuat kërkuesit mund të mos përbëjë rrezik për të tjerët. Ndërkohë akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor nr.108, datë 17 mars 2015 "Mbi ekzaminimin e shtetasit Astrit Avdyli", ekspertët psikiatër kanë konkluduar përfundimisht se qëndrimi i mëtejshëm në kushte burgu i këtij shtetasi i rrezikon jetën. Kaq ka mjaftuar që Gjykata e Lartë në 2 mars 2016, të prishë vendimin e gjykatës së Apelit Shkodër dhe të lirojë nga qelia Astrit Avdylin të dënuar me 16 vite për vrasje. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë shprehet: "Ndjekjen në rrugë ambulatore të gjendjes shëndetësore të kërkuesit Astrit Avdyli në përputhje me ligjin dhe aktet përkatëse dhe nënligjore". Por me sa duket Astrit Avdyli pasi ka dalë nga qelia ka filluar jo vetëm të kryejë disa vizita mjekësore por dhe të flasë dhe me njerës të pushtetshëm në Durrës, duke mbaruar punë nëpër zyrat e bashkisë Durrës, hipotekë, e inspektorate dhe duke drejtuar një kartel të fuqishëm të trafikut të heroinës në Evropë.

Zbardhet ekspertimi psiqik për Avdylin është i paparashikueshëm dhe i rrezikshëm

Çfarë shkruan dy mjekët në ekspertimin psiqik që ndikoi në lirimin e Astrit Avdylit nga burgu

Dy ekspertët mjeko-ligjorë Latif Fjolla dhe Shkëlqim Korbi që ishin ngarkuar nga gjykata për kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore ndaj Astrit Avdylit, kanë dalë me dy ekspertime të kundërta. Në konkluzionet që i kanë paraqitur gjykatës së shkallës së parë në Lezhë, dy ekspertët nxirrnin të sëmurë mendërisht Astrit Avdylin, por me një diagnozë tjetër. Ndërkohë në konkluzionet e dyta që i kanë paraqitur gjykatës së Apelit Shkodër, të dy ekspertët kanë dalë me përfundimin se Astrit Avdyli i dënuar me 16 vite burg për vrasje, vuan nga një sëmundje e rëndë mendore, por jo nga sëmundja që dy ekspertët kishin nxjerrë si konkluzion herën e parë në gjykatën e shkallës së parë në Lezhë. Gjykata ka arritur në përfundimin se ndryshe nga sa kanë arritur ekspertët e caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, grupi i ekspertëve të caktuar nga Gjykata e Apelit ka arritur në një diagnozë tjetër, atë të "Çrregullim psikotik i paspecifikuar me tentativa suicidale". Klinikisht paraqet çrregullime në formën e deluvioneve, të cilat udhëheqin sjelljet vetëdëmtuese dhe suicidale. Ekspertët, të pyetur edhe në seancë gjyqësore, kanë shpjeguar se shkaqet e sëmundjes së tij janë multifaktoriale, si për çdo individ tjetër me probleme të shëndetit mendor. Qëndrimi në burg me mjekimin aktual rëndon gjendjen shëndetësore të të dënuarit, pasi ai ka nevojë që të marrë ndihmë mjekësore të specializuar për një kohë të gjatë në kushte spitalore. Njëkohësisht grupi i ekspertëve mbi bazën e pyetjeve të gjykatës, ka specifikuar se i dënuari Astrit Avdyli prezanton sjellje të paparashikuara, për vete dhe për të tjerët, e cila me trajtim dhe ndjekje adekuate, mund të mos përbëjë rrezik për të tjerët. Gjykata, mbi bazën e pyetjeve të palëve ndërgjyqësve dhe ato të gjykatës, i kërkoi ekspertëve që të përcaktohej gjendja shëndetësore e të dënuarit Astrit Avdyli:

1. A kishte probleme shëndetësore?
2. Nëse po, cilat ishin ato?
3. A rrezikonte jetën e të dënuarit qëndrimi në burg dhe nëse po, cilat janë masat e nevojshme që duhen marrë për të eliminuar këtë rrezik?
4. Të përcaktohej nëse shëndeti mendor i të dënuarit në rast lirimi mund të rrezikonte ose jo, jetën e personave të tjerë?.

Grupi i ekspertëve, pasi mori në analizë të gjithë materialin shkresor të administruar dhe pasi bëri edhe një shtrim të të dënuarit në klinikë, për rreth një muaj, për të parë më mirë gjendjen shëndetësore të kërkuesit, paraqiti aktin e ekspertimit dhe aktin e ekspertimit shtesë, ku në konkluzion të të gjitha pyetjeve kanë konkluduar:

Astrit Avdyli prezanton probleme të shëndetit mendor.

Astrit Avdyli vuan nga Çrregullimi Psikotik i Paspecifikuar me Tentativa Suicidale. Klinikisht paraqet çrregullime të mendimit në formën e deluzioneve, të cilat udhëheqin sjelljet vetëdëmtuese dhe suicidale.

Astrit Avdyli ka manifestuar elementë psikotikë (halucinacione dhe deluzione), të paktën që prej vitit 2006, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, sikundër edhe elementë të humorit depresiv.

Trajtimi është kryer me antidepresivë në doza të ulëta, por nuk është filluar asnjëherë gjatë kësaj periudhe trajtim me antipsikotikë.

Shkaqet e fillimit të sëmundjes janë multifaktorialë, si për çdo individ tjetër me probleme të shëndetit mendor.

Simptomatika është rënduar me kalimin e viteve, sipas përshkrimit të sipërcituar në këtë akt, dhe vlerësimit gjatë hospitalizimit të fundit pranë QSB-së, për shkak të trajtimit të paspecializuar periodik dhe ndjekjes laboratorike për efektin e barnave dhe efektet anësore të tyre, si dhe moszbatimit të protokolleve të trajtimit.

Klinika që ka prezantuar ka qenë: viti 2016, përshkruhet SNQ nuk duket mirë, ankon për pagjumësi, ankth, çrregullime të sjelljes, deluzione, halucinacione pamore e auditive, pacienti ka bërë tentativë suicidale. Konsulta e parë psikiatrike konstaton mosorientim në hapësirë dhe kohë dhe ku konkludohet të kihet kujdes për tentativë suicidale. Në kartelën 415 përshkruhet: i axhituar, kërcënues dhe destruktiv. Me refuzim të marrjes së terapisë, halucinacione auditive, deluzione somatike përshkruhen të menduar depresiv dhe ide vetëvrasëse, referohet tentativë armiqësore, deluzione paranoide të interpretimit dhe helmimit.

Tentativat dhe të menduarit suicidal, pavarësisht etimologjisë së tyre sipas protokolleve të trajtimit kombëtar dhe ndërkombëtar, si edhe ligjit të shëndetit mendor, detyrimisht trajtohen me hospitalizim dhe ndjekje të specializuar.

Fillimi i një antipsikotiku, sipas protokolleve të trajtimit, zëvendësimi i tij në rast refrakrariteti (rezistencë terapeutike) apo kombinimi, vlerësimi i simptomatikës dhe ecurisë me anë të testeve vlerësuese (PANSS; BPRS), që kryhen nga specialisti psikiatër; ndjekja me ekzaminime periodike laboratorike dhe konsulta të tjera sipas algoritmit të trajtimit me antipsikotikë.

Sipas Guideline of American Psychiatric Association 2003, suicidi në ambientet e burgut është 4 herë më i lartë dhe te burrat 9-15 herë më i lartë. Ai ndikon negativisht duke qenë: a) terren përforcues i deluzioneve paranoide që prezanton; b) sjellja impulsive, axhitimi, gjykimi i dëmtuar, refuzimi i ndihmës, janë indikacione për hospitalizim; c) në pacientët e spektrumit psikotik tentativat për suicid ndodhin kur ka pasur eksperienca të episodeve depresive madhore, ose nga marrja e antidepresivit; d) impulsiviteti, armiqësia, agresioni, të ndara ose së bashku, rrisin riskun për suivid në pacientët me psikozë.

Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar në mënyrë progresive në rëndimin e gjendjes, me pasojë riskues si për ecurinë e sëmundjes prej të cilës vuan dhe riskun për vdekje të papritur prej barnave (problemet kardiake).

Aktualisht prej sëmundjes prej së cilës vuan dhe dëmtimit të gjykimit, shtetasi Astrit Avdyli prezanton sjellje të paparashikueshme për vete dhe të tjerët, e cila me trajtim dhe ndjekje adekuate mund të mos përbëjë rrezik për të tjerët.

AUDIO-PERGJIMET

5 gjyqtarët që liruan Avdylin u emëruan nga PD, si i 'dogji' Vetingu

Ja pesë anëtarë e Gjykatës së Lartë që liruan nga burgu për vrasje Astrit Avdylin, protagonistin kryesor të përgjimeve dhe që ka futur në konflikt politikën shqiptare

NGA ELTON QYNO & ADRIATIK DOÇI
REDAKSIA INVESTIGATIVE



5 gjyqtarët
Nëse pesë ish-anëtarë të Gjykatës së Lartë nuk do të lironin nga burgu në 2 mars 2016 Astrit Avdylin, klasa politike shqiptare nuk do të ishte 'mbërthyer' nga konfliktualiteti për dosjen 339/1. Ata janë Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Tom Ndreca dhe Guxim Zenelaj.

Shkarkimi
Që të pestë, të emëruar me forcën e kartonëve nga Partia Demokratike me në krye Sali Berishën, ose janë kanë 'mbathur' nga drejtësia nga frika e Vetingut ose janë shkarkuar nga detyra pikërisht nga organet e Vetingut.

Nëse pesë ish-anëtarë të Gjykatës së Lartë nuk do të lironin nga burgu Astrit Avdylin, i njohur ndryshe edhe si Niçja, klasa politike shqiptare nuk do të ishte 'mbërthyer' nga polemikat, debatet, akuzat dhe konfliktualiteti për dosjen 339/1. Ata janë Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Tom Ndreca dhe Guxim Zenelaj. Kjo trupë gjykuese, kryesuar nga Edmond Islamaj, në 2 mars 2016, në unison të plotë, ka vendosur lirimin nga burgu të anëtarit të bandës së Avdylajve, i dënuar me 16 vjet burg për vrasje. Ndër të tjera, në vendimin e zbardhur nga Shqiptarja.com, thuhet se "Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se lirimi i të dënuarit për shkak se i rrezikohet jeta, do t'i mundësojë atij aksesin në trajtim mjekësor të përshtatshëm që do të ndikonte në uljen e rrezikut që i kanoset jetës së këtij të dënuari, prandaj është e nevojshme ndjekja në rrugë ambulatore e gjendjes shëndetësore të kërkuesit Astrit Avdyli në përputhje me ligjin dhe aktet përkatëse dhe nënligjore për shëndetin mendor në Republikën e Shqipërisë". Dy vjet pas lirimit nga pesë ish-anëtarët e Gjykatës së Lartë, Astrit Avdyli u arrestua sërish, në kuadër të operacionit 'Volvo 4', tashmë me akuzën për trafik heroine në Shqipëri dhe Gjermani. Ndërkaq, sot, të pestë gjyqtarët që liruan nga burgu Astrit Avdylin nuk shërbejnë më në sistemin e drejtësisë. Që të pestë, të emëruar me forcën e kartonëve nga Partia Demokratike me në krye Sali Berishën, ose janë kanë 'mbathur' nga drejtësia për shkak të frikës nga Vetingu ose janë shkarkuar nga detyra pikërisht nga organet e Vetingut. Pesë ish-gjyqtarët janë emëruar nga Partia Demokratike në Gjykatën e Lartë në harkun kohor 2008-2013, në kuadër të planit për kapjen e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese me persona të besuar, para largimit nga pushteti, në shtator të vitit 2013.

PESË ISH-ANËTARËT E GJYKATËS SË LARTË QË LIRUAN ASTRIT AVDYLIN NGA BURGU

Edmond Islamaj, ish-anëtar i Gjykatës së Lartë, i emëruar në qershor të vitit 2011 (me votat e shumicës PD-LSI në Parlament), i shkarkuar përfundimisht nga detyra nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Edmond Islamaj ka kryesuar turpin gjykues që liroi nga burgu Astrit Avdylin në 2 mars 2016. Islamaj u konfirmua në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por u rrëzua nga Kolegji i Apelimit. Në vendimin e Kolegjit, ndër të tjera thuhet: "Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1,3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja "b", të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, trupi gjykues, në mënyrë unanime, bazuar në nenin D, pikat 1,3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 61, pika 3, si dhe nenin 66, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", vendosi: Ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj".

Shkëlzen Selimi, ish-anëtar i Gjykatës së Lartë, i emëruar në qershor të vitit 2011 (me votat e shumicës PD-LSI në Parlament), i shkarkuar në të dy shkallët e Vetingut. Shkëlzen Selimi ishte pjesë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që liroi nga burgu Astrit Avdylin në 2 mars 2016. Sipas Kolegjit të Posaçëm të Apelimit "Në lidhje me konstatimin e sa pasqyruar qartazi nga DSIK-ja, në raportin e saj për figurën e subjektit Shkëlzen Selimi, trupi gjykues


Edmond Islamaj


Shkëlzen Selimi

konstaton se Komisioni ka kryer një hetim të pavarur, nga i cili ka administruar si nga përfaqësuesit e ONM-së, ashtu edhe nga organet ligjzbatuese vendase të dhëna, të marra nëpërmjet dokumentacionit të klasifikuar "sekret", ku dëshmohet se si ky gjyqtar ka ushtruar ndikimin e tij me qëllim favorizimin e personave të lidhur me krimin e organizuar. Në konkluzion dhe në përfundim të arsyetimit të mësipërm dhe të shqyrtimit të çështjes në tërësinë e saj, trupi gjykues çmon se ankimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron në tërësinë e tij dhe se asnjë prej shkaqeve të paraqitura prej tij nuk cenon bazueshmërinë në fakte e ligj të vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, prandaj, si i tillë, ai duhet të lihet në fuqi".

Artan Zeneli, ish-anëtar i Gjykatës së Lartë, i emëruar në qershor të vitit 2011 (me votat e shumicës PD-LSI në Parlament). Ishte pjesë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që liroi nga burgu Astrit Avdylin në 2 mars 2016. Artan Zeneli është shkarkuar në të dy shkallët e Vetingut për shkak të problemeve me ligjshmërinë e pasurive. Ndër të të tjera në vendimin e Kolegjit të Apelimit për Artan Zenelin thuhet: "Lidhur me pasurinë nr. 2, banesë dykatëshe, me sipërfaqe 188 m2 dhe oborr me sipërfaqe 337,25 m2... Artan Zeneli ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerë pasurinë me vlerë 41.142 lekë. Lidhur me pasurinë nr. 3, apartament banimi 3 + 1, me sipërfaqe 117 m2, në rrugën {***}, Tiranë, fituar me kontratën e shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 27.05.1999, me vlerë 41.000 USD, rezulton se subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Nga analiza ligjore dhe financiare e shkaqeve ankimore, që i përkasin pasurisë nr. {***}, apartament banimi me sipërfaqe 212 m2, në rr. {***}, pall. {***}, Tiranë, me vlerë 100.000 USD..., rezulton se për periudhën 1991-2003, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në vlerën 11.596.039 lekë për të justifikuar pasurinë e krijuar".

Tom Ndreca, ish-anëtar i Gjykatës së Lartë, Ndreca është propozuar nga ish-presidenti Bujar Nishani, ndërsa është votuar në Parlament nga PD më 03.05.2013, një muaj para zgjedhjeve parlamentare. Ishte pjesë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që liroi nga burgu Astrit Avdylin në 2 mars 2016. Tom Ndreca është shkarkuar në të dy shkallët e Vetingut, për shkak të mosjustifikimit të pasurisë dhe kontakteve me një person të inkriminuar. Ndër të tjera, në vendimin e Kolegjit të Apelimit për Tom Ndrecën thuhet: "Trupi gjykues mbështet qëndrimin e Komisionit edhe në drejtim të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit. Mosdeklarimi i një kontakti të papërshtatshëm në formularin për kontrollin e figurës është parashikuar prej nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si një element që prezumon vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe subjekti i rivlerësimit, megjithëse i gjendur në këto kushte, nuk arriti të provojë në hetim të kundërtën e këtij fakti apo motive a argumente ligjore që e zhvishnin atë nga kjo përgjegjësi. Në këtë kuptim, Kolegji e gjen të drejtë edhe qëndrimin e Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016".

Guxim Zenelaj, i larguar nga Gjykata e Lartë në vitin 2017, për shkak të mbarimit të mandatit. Është emëruar në 31.07.2008 nga Partia Demokratike, me propozim të Bamir Topit. Guxim Zenelaj ishte pjesë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që liroi nga burgu Astrit Avdylin në 2 mars 2016. Sipas ligjit, Guxim Zenelaj, mund të shërbente në Gjykatën e Lartë deri kur organet ligjzbatuese të mundësonin zëvendësimin e tij. Por, Guxim Zenelaj, zgjodhi të largohej, duke kontribuar në bllokimin e Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, vendimi për t'u larguar, në kushtet kur mund të qëndronte deri në zëvendësimin e tij, krijon dyshime se, kjo lëvizje është diktuar nga frika e përballjes me skanerin e trefishtë të Vetingut, për ligjshmërinë e pasurive, pastërtinë e figurës dhe aftësitë profesionale. Dyshimet shtohen në kushtet kur, ndryshe nga ish-anëtarja e Gjykatës së Lartë Arjana Fullani, e cila gjithashtu është larguar për shkak të mbarimit të mandatit, por që ka kërkuar t'i nënshtrohet Vetingut, Zenelaj nuk e ka shprehur deri më sot një vullnet të tillë.


Artan Zeneli


Tom Ndreca


Guxim Zenelaj

RAMA LË DAKON NË DUART E DREJTËSISË

Rama: Prokuroria reagim të vonuar! PD bën gjyqe publike

Rama
"Po dëgjoja kryesuesen e Krimeve të Rënda, ndonëse me vonesë, por ka shpjeguar arsyen pse këto zbulime të mëdha që janë abuzim me ligjin e nxjerrje sekreti hetimor, për të bërë politikë e përdorur kundër Shqipërisë".



Kryeministri Edi Rama komentoi dje deklaratën e drejtueses së Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Donika Prela mbi dosjen e përgjimeve të bëra publike nga gazeta gjermane "Bild". Ai e ka cilësuar këtë reagim si të vonuar, në një kohë kur "vendi po ziente" me lajme të tilla. "Po dëgjoja kryesuesen e Krimeve të Rënda, ndonëse me vonesë, por ka shpjeguar arsyen pse këto zbulime të mëdha që janë abuzim me ligjin e nxjerrje sekreti hetimor, për të bërë politikë e përdorur kundër Shqipërisë. Dëgjojini dhe lexojini kush janë personat që i kanë mbajtur në sirtar këto zbulime të mëdha. Njëri nga ata, apo dy i kanë çuar tek partia për t'i përdorur për politikë. Sepse ata i bashkojnë shumë gjëra, lufta ndaj reformës në drejtësi. Kemi prokurorë që tmerrohen nga Vetingu dhe politikanë që tremben nga Vetingu", tha Rama. Rama ka theksuar Partia Demokratike po bën gjyqe publike, pa u bazuar në fakte apo prova, pasi sipas tij, mbi bazën e këtyre përgjimeve nuk mund të dilet në përfundimin që kryebashkiaku Vangjush Dako është fajtor. Këtë, theksoi kreu i qeverisë, e vendos vetëm drejtësia. "Përgjimet e neveritshme, se askush nuk mund të çohet dhe të thotë që ne kemi hapur gojën apo për të çuar dorën për të penguar drejtësinë. Nuk na ka parë askush për të marrë në mbrojtje këdo qoftë që duhet të dalë para drejtësisë, ajo do e vendos kush është i fajshëm apo i pafajshëm. Drejtorin e Tatimeve ata (PD) e kishin të dënuar dhe e çonin përditë si të pafajshëm deri në vendimin e formës së prerë. Ne e kemi bërë të qartë ndarjen, drejtësia ka punën e vetë dhe prandaj jemi e vetmja forcë për të çuar deri në fund atë reformë në drejtësi. Ata duan që të bëjnë gjyqe popullore, pa prova, pa hetime pa asgjë", tha Rama. Këto deklarata, kryeministri Edi Rama i bëri teksa ishte i pranishëm në Urën Vajgurore, ku prezantoi përpara banorëve kandidaten për kreun e Bashkisë, Juliana Memaj.

Prela: Nga 624 CD, prokurorët urdhëruan transkriptimin selektiv

Prela: Një prokuror po heton rrjedhjen e informacionit. Nuk janë në hetim prokurorët aktual të dosjes

Drejtuesja e prokurorisë së Krimeve të Rënda, Donika Prela doli për herë të parë në një deklaratë për mediat ku dha detaje për procedimin penal numër "339", dosjen e shumëpërfolur, nisur si hetim për një grup kriminal të trafikut të heroinës që më tej gjatë përgjimeve doli edhe përfshirja e kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako dhe disa zyrtarëve të tjerë, me dyshimin për shit-blerje të votave në zgjedhjet parlamentare të 2017-ës. Prela tha se ka zgjedhur të heshtë deri në këto momente, pasi "një prokuror i mirë flet përmes vendimeve dhe akteve juridike". Duke e cilësuar dosjen më të madhe që është hetuar ndonjëherë në historinë e prokurorisë shqiptare, drejtuesja e Krimeve të Rënda zbuloi se në total janë 74 persona në hetim, dhe ky numër pritet të rritet. "E them pa frikë që kjo është dosja me e madhe që ka pasur prokuroria shqiptare në historinë e saj. Duke parë rëndësinë e madhe të çështjes, por dhe sensitetin e saj, numrin shumë të madh të personave në hetim me masa të ndryshme sigurimi, ku aktualisht numri i personave në hetim ka shkuar në 74 persona (dhe pritet të rritet në vijimësi), janë sekuestruar 300.000 m2 tokë, resort turistik etj., pra është kryer në volum i konsiderueshëm hetimesh. Nga drejtuesi i prokurorisë në zbatim të detyrimeve ligjore, por dhe njëkohësisht të kompetencave që lejon ligji, janë marra masa të shumta organizative me qëllim lehtësimin e punës së prokurorëve të ngarkuar me hetimin e çështjes me qëllim përfundimin sa më të shpejtë në kohë të tyre", u shpreh Prela.

SI NDRYSHOI RRJEDHA E HETIMIT

Prela bëri një përshkim të ecurisë së kësaj dosje e cila ka kaluar dorë më dorë tek Prokurorë të ndryshëm për shkak të transferimit dhe lëvizjeve në organin e akuzës. Ajo që bie në sy, është fakti se për vetëm në një muaj, dy prokurorët Vladimir Mara dhe Dritan Prençi që e morën hetimin e dosjes pas kolegut të tyre Hajdarmataj kërkuan 44 masa arresti për personat e përshirë edhe zgjeruan hetimet edhe për shit-blerje votash, përveç veprave penale të ngritura nga Hajdarmataj, ish-drejtues i Prokurorisë për Krime të Rënda në kohën e kryeprokurorit Adriatik Llalla. Hajdarmataj drejtoi hetimet e dosjes nga 20 nëntor 2017 deri në 21 shtator 2018, ku vetëm 4 ditë më pas dosja i kaloi Marës dhe Prençit. "Në një periudhë

Prela
"E them pa frikë që kjo është dosja me e madhe që ka pasur prokuroria shqiptare në historinë e saj. Aktualisht numri i personave në hetim ka shkuar në 74 persona".

Hetimet
"Prokuroria e Krimeve të Rënda është duke kryer hetimet veçanërisht për shkeljet në fushën e zgjedhjeve por edhe për nxjerrje të sekretit hetimor. Në dijeninë time Prokurorët e çështjes nuk janë në hetim".

kohore me pak se 20 ditë pas zëvendësimit të prokurorit, me urdhrin e datës 18.10.2018, nga prokurorët e çështjes, janë regjistruar emrat e 40 subjekteve, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të ndryshme, të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimit të narkotikëve, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal", "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, "Falsifikimi i dokumenteve", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Shpërdorimi i tokës", etj., të kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe vepra penale të tjera. Po kështu në fund të muajit tetor 2018, një muaj pasi dosja është marrë në hetim, janë nxjerrë gjithsej 44 masa sigurimi arrest në burg për persona të ndryshëm për veprat penale të sipërcituara", tha Donika Prela.

RRJEDHJA E INFORMACIONIT

Sa i përket hetimit të nisur për nxjerrje të sekretit hetimor, lidhur me audio-përgjimet e publikuara dy ditë më parë në tabloidin gjerman "Bild", Prela tha është caktuar një prokuror i veçantë për të zbuluar nga ka rrjedhur informacioni. Por ajo përjashtoi dy prokurorët aktual të hetimit të dosjes, Vladimir Marën dhe Dritan Prençin. "Janë duke u kryer hetime edhe për faktet e nxjerrjes së sekreteve hetimore për të cilët është caktuar një prokuror i veçantë. Prokuroria e Krimeve të Rënda është duke kryer hetimet veçanërisht për shkeljet në fushën e zgjedhjeve por edhe për nxjerrje të sekretit hetimor. Në dijeninë time Prokurorët e çështjes nuk janë në hetim", tha Prela.

ÇFARË KA BRENDA 624 ÇD-VE ME PËRGJIME?

Kryeprokurorja e Krimeve të Rënda tha se në tetor të 2018-ës, nga 624 CD në total me përgjime, vetëm një numër shumë i vogël i tyre, i zgjedhur në mënyrë sporadike, ishte transkriptuar. Çka do të thotë se prokurori Besim Hajdarmataj deri në momentin që la dosjen, 2 vite nga nisja e hetimeve, nuk kishte transkriptuar përgjimet. "Në kuadër të hetimeve, janë administruar gjithsej 624 CD me regjistrime të përgjimeve elektronike dhe 115 DVD. Nga këto, janë



110 CD për vitin 2017, 479 CD për vitin 2018 dhe 35 CD për vitin 2019. Sqarojmë se referuar Informacionit që më është vënë në dispozicion nga dy prokurorët e çështjes, në momentin e ngritjes së grupit hetimor nga ana e drejtuesit të prokurorisë tetor 2018, të gjitha CD e administruara kanë qenë të patranskriptuara në tërësi dhe vijimësi, por ka pasur transkripte të pjesshme, vetëm të disa numrave të veçantë, dhe në mënyrë sporadike", tha Prela.

DOSJA TASHMË ËSHTË NË DUART E 2 PROKURORËVE DHE 11 OFICERËVE

Procedimi penal për grupin kriminal është regjistruar në 28 dhjetor 2016. I pari prokuror i kësaj dosje ishte Anton Martini dhe dy oficerë të Policisë Gjyqësore. Pas 1 viti ai është transferuar në Shkodër. Dhe në 20 dhjetor 2017 dosjen e ka marrë në dorë Besim Hajdarmataj dhe tre oficerë të Policisë Gjyqësore. Sot dosja është në duart e Vladimir Marës dhe Dritan Prençi dhe me 11 oficerë të Policisë Gjyqësore të cilëve u janë caktuar detyrat përkatëse nga prokurorët. Ndërkohë, siç Prela theksoi - nga tetori 2018, dy prokurorët e çështjes, "janë përjashtuar nga grafiku i gatishmërisë mujore si dhe nga pjesëmarrja në shortet e organizuara për shpërndarjen e materialeve të reja hetimore apo të procedimeve të tjera penale të reja, për një periudhë 6 mujore me urdhra të veçantë të drejtuesit të nxjerrë me afat përjashtimi çdo muaj ose çdo dy muaj".

Intervista
TIRANE

Vangjush Dako shuan misterin dhe rrëfen me kë ka folur te 'përgjimet'

Kreu i Bashkisë së Durrësit në Report Tv: Nuk mbaj mend të kem folur ndonjëherë në celular me Avdylajn



Kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, i ftuar në emisionin "Repolitix", me gazetarin Denis Minga, në Report Tv, ka zbuluar mbrëmë personin me të cilin ka folur në audiopërgjimin e publikuar nga gazeta gjermane "Bild". Dako është shprehur se ai nuk është zëri i Astrit Avdylit, por i një familjari të tij, ndonëse nuk ka thënë një emër konkret. Kryebashkiaku theksoi se ajo telefonatë është manipuluar, me qëllim që të krijohet një lidhje Dako-Avdylaj, gjë për të cilën ai thotë se është e pabazuar askund. "Unë e kam thënë që nuk është Astrit Avdylaj, është një person nga familja e tyre i cili komunikon me mua, por jo Astrit. Kjo jo se ndryshon rrjedhjen e telefonatave, por është manipuluar me qëllim që të lidhin të gjithë telefonatat e tjera, 5 të tjerat me Vangjush Dakon. Ka qenë një mendje djallëzore për të çorientuar opinioni publik. Në këtë rast, kjo telefonatë nuk është zëri i Astrit Avdylaj. Nuk mbaj mend të kem folur ndonjëherë në celular me Avdylajn", u shpreh Dako.

'PËRGJIMET E SAJUARA PËR TË JUSTIFIKUAR DJEGIEN E MANDATEVE NGA PD'

Për kryebashkiakun,Vangjush Dako pas publikimit të këtyre e audio-përgjimeve nga "Bild", qëndron e fshehur pikërisht opozita. Këta të fundit, sipas tij, e kanë përdorur si një formë, për të justifikuar vendimin e tyre drastik për të djegur mandatet. Ai është shprehur i bindur se materialet nga dalë nga Prokuroria, por ka zgjedhur që të mos flasë me emra se për tek cili prokuror dyshon. "Ndjej një përbuzje që kjo histori është ngritur për të manipuluar opinionin publik, që votat janë vjedhur dhe se mazhoranca aktuale ka ardhur nga votat e vjedhur. PD po justifikon humbjen e tyre me këtë përgjime dhe që protesta e tyre e nesërme të marrë mbështetje. Kjo farsë sajohet që ata kanë të kenë një kauzë për të legjitimuar pse dolën nga parlamenti dhe të baltosin figurë time. Garantoj të gjithë qytetarët që në Durrës votat nuk janë vjedhur, as nga bandat e as nga mazhoranca. Nuk ka ndryshuar rezultati nga manipulimi. Kjo çorbë është gatuar në zyrat e partisë Demokratike dhe e kanë çuar te gazeta gjermane. Pa diskutim që materialet kanë dalë nga Prokuroria", tha Dako.

DAKO SHPJEGON 'PËRKËDHELITË' PËR AVDYLAJN

Ndonëse në përgjimet e publikuara nga "Bild" nuk ka asgjë konkrete për shit-blerjen e votave në Durrës dhe Shijak, opozita ka folur për një lloj konfidence që tregohet mes kryebashkiakut të Durrësit, Dako dhe Astrit Avdylit. Kjo sipas tyre mund të vërehet tek termat e përdorur si "lal' "vëlla" "zotëri", por një gjë e tillë është kundërshtuar nga Dako. Ai ka thënë se pikërisht kjo mënyrë e të folurit është tregues që ai nuk ka asnjë konfidencë me personin që flet në telefon. "Komunikoj me shumë zgjedhës në celular, por nuk mbaj mend që të kem folur ndonjëherë me Astrit Avdylaj në telefon. Live në takime, ka qenë rasti që kemi folur, jo...ndoshta, por unë nuk e mbaj mend...Telefonata "ça bën, si je, motër/vëlla", ndonjëherë madje shumë shpesh nuk e di se me kë je duke folur dhe po nuk pate nr telefonit këto shprehje "lal, zotëri" janë shprehje që përdorin nga gjithë njerëzit kur nuk i njeh dhe s'ke konfidencë. Sepse kur nuk e njeh e thërret me emër", sqaron Dako.

DAKO: SI E KAM NJOHUR ASTRIT AVDYLAJN

Vangjush Dako në studion e "Repolitix" në Report Tv ka rrëfyer se si ka njohur Astrit Avdylajn dhe rolin që ka pasur ai në fushatën e Partisë Socialiste në zgjedhjet e kaluara. "Rreth vitit 2016-2017 kam dëgjuar për Astrit Avdylajn. Kemi pirë një kafe në Shijak pas një aktiviteti elektoral, kemi qenë rreth 10-15, mes tyre dhe Astrit dhe shumë persona të tjerë që na kanë përshëndetur, na kanë mbështetur për PS, që do të japim maksimumin që PS të fitojë sërish zgjedhjet në Shijak. Familja Avdyli është një fis i madh në Shijak dhe njihen si mbiemra, pa i ditur se kush është me fytyra, por s'kam pasur asnjë kontakt personal me ta para 2016. Këta kanë intensifikuar të gjitha kontaktet, kanë qenë aktivë për të ndihmuar PS, por nuk është kërkuar që të manipulojnë, që të shesin apo blejnë vota në Durrës, as ata dhe as unë s'u kam kërkuar. Ata nuk kanë përfituar asgjë të jashtëligjshme nga Bashkia e Durrësit dhe në dijeninë time as nga Bashkia e Shijakut. Ne nuk i konsiderojmë grupe. Familjet mafioze i konsideron prokuroria, gjykata, organet kompetente. Ne i konsiderojmë njerëz me influenca që kanë një fis të madh që kanë një rreth miqësor, që japin një mbështetje për të mbledhur sa më tepër vota. Këto i kanë të gjitha partitë, të gjithë bëjnë punë e vet. Ajo që ne kërkojmë është që mos të ketë manipulim, mos të ketë vjedhje votash dhe të vendosim ne njerëzit tanë për t'i ruajtur, komisionarët. Edhe pala tjetër bën të njëjtën gjë", tha Dako.

PËR AGRON DUKËN

Agron Duka, kryetar i Partisë Agrare Ambientaliste, është ndër personat që e ka akuzuar Vangjush Dakon se në dijeni të kryeministrit Edi Rama ka vjedhur votat. I ftuar në "Repolitix" me gazetarin Denis Minga, kryebashkiaku i Durrësit, tha se vetë PD nuk ka pasur asnjë denoncim në vitin 2017 për korrupsion zgjedhor. Ai thotë se sulmet e Dukës vijnë për shkak se ai nuk ishte i zoti në qytetin e Durrësit as të hapte një shtab elektoral, ndërsa shkon edhe më tej kur thotë se ai mund të ketë edhe probleme mendore. "Paaftësia, marrja fund politikisht e Agron Dukës që në vitin 2005,e ka bërë të mos jetë njeri i centruar mirë. Nuk është normal në të gjitha fjalët që ai thotë. Po ta vësh re nga vitit 2005 e sot ka edhe lëvizje edhe ndoshta mendore , dhe jo vetëm lëvizje fizike nga njëra parti në tjetrën me çdo instrument për të qenë në parlament. Për gjithë këtë paaftësi që ka, e nxjerr dobësinë e tij sikur i është manipuluar vota, sikur i është vjedhur. Agron Duka dhe PD në këto zgjedhje ka qenë forca më e paaftë politike në këto 12 vite që unë merrem me zgjedhje. Ka qenë një parti që nuk ka pasur asnjë organizim. Duka vinte nga PR, Agrare, dhe nuk kishte një njeri që t'i organizonte, apo t'i hapte një shtab elektoral, sepse njerëzit e PD nuk e donin dhe nuk e duan. Për këtë arsye ai nuk gjente asnjë mbështetje në Shijak dhe në gjithë zonën e Durrësit", tha në Repolitix kryebashkiaku i qytetit bregdetar. Në një nga përgjimet që Prokuroria çoi tek tabloidi gjerman "Bild" publikuar dy ditë më parë, një votues që flet me Astrit Avdylin. "Mos ta marrë vesh Agron Duka", thotë ai ndër të tjera teksa premton votën për PS. "Qenka edhe me Agron Dukën ai? Ai thotë kam qenë gjithmonë me PS. Të njëjtat fjalë mund t'ia thotë edhe Dukës: "Unë jam me ty po mos i thuaj Dakos". Ose Astrit Avdyli luan me dy porta edhe me PS edhe me Dukën. Agron Duka e ka humbur ekuilibrin politik, ka ndërruar 4-5 parti në një periudhë 10-vjeçare", tha Dako.

Biseda e parë mes Astrit Avdylajt dhe Vangjush Dakos- (pa datë)/

(DAKO THEKSON QË NUK ËSHTË ASTRIT AVDYLAJ)

Astrit Avdylaj: A të ka zënë gjumi mbrëmë vëlla, se ke takuar Ramën dje, keni ndjeur, jeni kënaqur?
Vangjush Dako: Hehehehe
Astrit Avdylaj: Ça bohet?
Vangjush Dako: Ça bohet?
Vangjush Dako: Mirë, mirë...
Astrit Avdylaj: Nga je vëlla?
Vangjush Dako: Dëgjo
Astrit Avdylaj: Hë vëlla...
Vangjush Dako: Thuaj byrazerit unë po iki në Ishëm te ata çunat
Astrit Avdylaj: Jo pra tashi, se do ta lëmë më vonë, se jam tani me çunat (Vath Alla)
Vangjush Dako: Ku je ti?
Astrit Avdylaj: Këtej nga Hipoteka duke pritur Anin (Ani Dyrmishi asokohe drejtor i Hipotekës në Durrës, tani drejtor i Hekurudhave). Ani do të vijë të takojë ty, drejtori apo jo?
Vangjush Dako: Janë aty ata apo?
Astrit Avdylaj: Po, Vath Alla është këtu me mua direkt, drejtpërdrejt, live përballë në tavolinë po na dëgjon
Vangjush Dako: E mirë takohemi në Durrës atëherë...
Astrit Avdylaj: Jo, takohemi atje, e kemi lënë orarin atje vëllai, mbaroi, do takojm atje, nga dreka se s'bën, të mbarojmë pak punë me Anin këtu se tha do shkoj te bashkia tha ai, po e pres te hipoteka vëllai
Vangjush Dako: Mirë, mirë
Astrit Avdylaj: Hajt, të du fort vëllai jot

Detajet

PËRGJIMI
"Unë e kam thënë që nuk është Astrit Avdylaj, është një person nga familja e tyre i cili komunikon me mua, por jo Astrit. Është manipuluar me qëllim që të lidhin të gjithë telefonatat e tjera, 5 të tjerat me Vangjush Dakon".

DAKO
"Kjo farsë sajohet që ata kanë të kenë një kauzë për të legjitimuar pse dolën nga parlamenti dhe të baltosin figurë time. Garantoj të gjithë qytetarët që në Durrës votat nuk janë vjedhur, as nga bandat e as nga mazhoranca".

DEKLARATA / BASHA: BANDAT JANË SHTABE ELEKTORALE TË PS

Basha: Nuk mund të konkurronim me kriminelët!

Basha
"Bandat janë shtabe elektorale të Partisë Socialiste, kokat e krimit konsiderohen si shefa të tyre nga administrata publike, bandat caktojnë dhe marrin përfaqësuesit e tyre në Kuvend me siglën e PS-së".



Lideri demokrat Lulzim Basha në një deklaratë për mediat pasditen e djeshme foli lidhur me atë që ai e quan ardhje në pushtet të PS-së në bashkëpunim me krimin. Ai u ndal veçanërisht në qytetin e Durrësit. "Sikurse e pa gjithë bota, në Durrës, sot nuk ka më asnjë dallim dhe asnjë vijë ndarëse mes krimit dhe Partisë Socialiste dhe institucioneve të pushtetit që kontrollon Partia Socialiste. Bandat janë shtabe elektorale të Partisë Socialiste, kokat e krimit konsiderohen si shefa të tyre nga administrata publike, bandat caktojnë dhe marrin përfaqësuesit e tyre në Kuvend me siglën e PS-së, ndërsa drejtues socialistë koordinojnë çdo veprim politik me kriminelët. Kjo gjendje nuk është kapje e shtetit nga krimi, është shkrirje e shtetit dhe krimit në një. Për të arritur në këtë pikë, që ditët e para Edi Rama lejoi dhe mbrojti kultivimin dhe trafikun ndërkombëtar të kanabisit në të gjithë Shqipërinë: Nuk duhet patur asnjë dyshim, ishte një projekt i qëllimshëm dhe i vetëdijshëm i Edi Ramës, i cili e sheh krimin dhe drogën si faktor ekonomik", tha Rama. Kreu demokrat tha se një nga arsyet pse PD ka zgjedhur të mos marrë pjesë në zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019, është se nuk mund të konkurrojnë politikisht - sipas tij me kriminelët. "Ata që mendojnë ndryshe janë të verbër ose naivë. Edi Rama është i zhytur në krim. Edi Rama duhet të ikë", theksoi ai. Edhe pas ikjes së tij - theksoi shefi i opozitë jo parlamentare - "do të duhen shumë kohë për të çrrënjosur themelet e korrupsionit". "Shumë njerëz na kanë marrë për Don Kishot, por sot Don Kishotët janë ata", u shpreh Basha në deklaratën për mediat nga selia blu. Kreu demokrat i bëri thirrje qytetarëve që të marrin pjesë sot në protestën e opozitës joparlamentare në orën 19:00, i teti tubim kombëtar kundër qeverisë.

Mediat gjermane: Merkel shtyn për në tetor hapjen e negociatave

Ambasadori i Bashkimit Europian në Shqipëri Soreca: Shqipëria ka bërë progres që nga qershori i 2018-ës

Sipas një raportimi të gazetës së njohur gjermane, Suddeutsche Zeitung" të premten (07.06) kancelarja gjermane, Angela Merkel i ka bërë një refuzim të qartë kërkesës së Komisionit Europian për hapje të shpejtë të negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Këtë ajo e ka thënë në një seancë të komisionit parlamentar të Bundestagut për Evropën, sipas informacioneve të "Suddeutsche Zeitung". Merkel ka bërë të qartë, se një vendim për këtë pritet më së hershmi në tetor. Me këtë kancelarja del qartazi kundër partnerit në koalicion, Partisë Socialdemokrate, SPD, që përkrah votimin pro për hapjen e negociatave në Këshillin e BE më 18 qershor. Ministri gjerman i Shtetit për Europën në Ministrinë e Jashtme, Michael Roth (SPD) është një nga politikanët gjermanë që është angazhuar fort javët e fundit për hapjen e negociatave me dy vendet e Ballkanit. Ai ka thek-



suar në intervista të ndryshme, se angazhimi i Shqipërisë për reforma duhet të vlerësohet.

CDU/CSU DHE SPD ME QËNDRIME TË NDRYSHME

Mospërputhja e qëndrimeve brenda koalicionit qeverisës gjerman u vu re hapur pas publikimit të progres-raportit të Komisionit Europian në fund të majit. KE kërkoi hapjen e shpejtë të negociatave si me Shqipërinë ashtu edhe Maqedoninë e Veriut. Por CDU/CSU është e rezervuar edhe këtë vit, ajo ka nevojë për analizë të kujdesshme raportit. Deputeti gjerman i CDU, dhe kryesues i grupit parlamentar për Ballkanin Perëndimor në Bundestag, Johann Wadepuhl, ka thënë se CDU/CSU do duhet të shqyrtojë me kujdes raportet e progresit mbi Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. "Vetëm në këtë mënyrë mund të marrim një vendim të përgjegjshëm nëse janë plotësuar me të vërtetë kushtet e fillimit të negociatave për anëtarësim të këtyre dy vendeve në BE", ka thënë Wadephul në një deklaratë të publikuar menjëherë pas publikimit të progres-raportit të KE në fund të majit. Për Wadephul,

Luigi Soreca

"Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm që nga qershori 2018. Së pari progres ka pasur në fushën e drejtësisë, ku janë bërë hapa me rëndësi. Këtu vlen të përmendet edhe reforma në drejtësi, si kryereformë e vendit".

Shqipëria nuk ka plotësuar asnjë nga kushtet e caktuara në Këshillin e Ministrave të Jashtëm, të datës 28 qershor 2018.

SORECA: SHQIPËRIA KA BËRË PROGRES

Ambasadori i Bashkimit Europian në Shqipëri, Luigi Soreca tha në një intervistë për 'Euronews' se Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm që nga qershori i vitit 2018. Soreca deklaron se pretendimet e njëpasnjëshme të opozitës po shqyrtohen. Ai shton se opozita ka publikuar përgjime dhe të tjera materiale që duken kompromentuese. Soreca shprehet se opozita duhet ta dëshmojë me fakte se kemi të bëjmë me shkelje ligji e nëse vërtetë ka thyerje ligjore, atëherë BE mbështet tërësisht zbatimin e ligjit. Ambasadori i bën thirrje për bashkim të të gjitha partive që t'i japin fund krizës dhe të dërgojnë Shqipërinë drejt BE-së. "Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm që nga qershori 2018. Së pari progres ka pasur në fushën e drejtësisë, ku janë bërë hapa me rëndësi. Këtu vlen të përmendet edhe reforma në drejtësi, si kryereformë e vendit. Kemi të bëjmë me një reformë të pashembullt të reformimit të gjyqësorit në Shqipëri, që nuk është parë në Europë e në botë. "I bëj thirrje të gjitha partive politike që të kapërcejnë ngërçin aktual dhe të marrin në konsideratë interesin kombëtar të shqiptarëve si drejtimin më të mirë për vendin", thotë Soreca për Euronews.

Të gjithë me sytë nga presidenti/ Meta i 'delegon' kompetencat CDU/CSU

Në një kohë kur vendi është në një krizë politike për mungesë të dialogut mes qeverisë dhe opozitës e cila ka bojkotuar zgjedhjet lokale, presidenti Ilir Meta ndodhet në Berlin. Siç njofton zyra për shtyp e presidencës, Meta u takua dje me përfaqësues të grupeve parlamentare kryesore të Bundestagut ku u diskutua lidhur me perspektivën evropiane të vendit, dhe veçanërisht për çeljen e negociatave të anëtarësimit me BE. Ai pati takim me nënkryetarin e Grupit Parlamentar CDU/CSU, Johann Wadephul



dhe Raporterin për Shqipërinë për CDU/CSU në Komisionin e Jashtëm, Christian Schmidt. Meta vlerësoi angazhimin e tyre si dhe gatishmërinë për të ndihmuar në kapërcimin e krizës dhe për rivendosjen urgjent të dialogut politik, gjë për të cilën u angazhua edhe vetë ai duke ofruar edhe dorëheqjen nga posti i presidentit. Duket se tani edhe vetë presidenti i ka shpresat nga një influencë që do të vijë nga përtej kufirit për të ulur në dialog liderët politikë në vend. Presidenti Meta u takua gjithashtu me Zëdhënësin për Politikën e Jashtme të Grupit Parlamentar SPD në Komisionin e Politikës së Jashtme, Nils Schmid, të cilin e falënderoi për mbështetjen për çeljen e negociatave të anëtarësimit, dhe në tërësi për procesin e integrimit evropian. Kreu i Shtetit zhvilloi një takim të veçantë dhe me deputeten e CSU, Raportere për Shqipërinë në Komisionin e BE-së në Bundestag, Katrin Staffler me të cilën gjithashtu bisedoi mbi perspektivën e çeljes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE.

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.,** njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurisë së paluajtshme:

"Apartament", me sipërfaqe 122.28 m2, me Nr. Pasurie 23/152+1-14, zk. 8641, vol. 22, faqe 13, me vendndodhje në Sarandë, në pronësi të Niko Illo Çollaku.

Çmimi fillestar i ankandit është **72,000 (shtatëdhjetë e dy mijë) Euro.**

ANKANDI PËR PASURITË E MËSIPËRME ZHVILLOHET NË DATË **17.06.2019.**

Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

STRATI BAILIFF SERVICE

Alarmi nga agjensitë partnere: Protesta e sotme do të jetë e dhunshme

Hipotezohet që përshkallëzimi i dhunës nga opozita joparlamentare t'i hapë rrugë një skenari të mundshëm të shtyrjeve të datës së zgjdhjeve nga Presidenti



Protesta e sotme e opozitës joparlamentare, ka shumë gjasa që të ketë episode të dhunshme edhe më të përshkallëzuara se në ato të mëparshmet. Shqiptarja.com mëson se një informacion i tillë ka mbërritur tek agjensitë shqiptare të sigurisë nga agjensitë e huaja partnere. Sipas informacioneve që kanë grumbulluar agjensitë e shërbimeve të vendeve partnere pritet që në protesëtn e sotme të PD-LSI të ketë një përshkallëzim të dhunës. Rikujtojmë se për shkak të këtyre informacioneve për një dhunë të përshkallëzuar në protestat e opozitës joparlamentare Policia e Shtetit ka njoftuar se efektivët e policisë që janë në detyrë për mbarëvajtjen e protestës janë të gjithë të paarmatosur.

Në fakt që një javë më parë në përfundimin e protestës së 2 qershorit kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka paralajmëruar në mënyrë indirekte se protesta e radhës do të jetë më e dhunshme se të tjerat, nëse kryeministri Edi Rama nuk largohet nga pushteti për t'i hapur rrugë zgjedhjeve të parakoshme. "Ne nuk do të hedhim asnjë hap pas, e sotmja është dita e fundit që unë i drejtohem me forcën e argumenteve pasi fjalët po mbarojnë. Në protestën e ardhshme nuk do të ketë më fjalë. Largohu, ose ndryshe ndjeja zërin popullit në protestën e ardhshme", tha Basha nga selia e PD-së kur paralajmëroi se protesta e radhës do të bëhej më 8 qershor.

Tashmë duket se këto fjalë të Bashës nuk ka qenë thjesht një kërcënim i lëshuar nën efektet e adrenalinës në fund të protestës së 2 qershorit. Agjensitë e e huaja të shërbimeve të sigurisë kanë informacione se opozita joparlamentare po përgatitet për të prodhuar jo vetëm një protestë masive më 8 qershor, por edhe të dhunshme.

Por për çfarë mund t'i shërbejë dhuna PD-së e LSI-së, kur në çdo pragproteste të tyre, por edhe më pas, i gjithë faktori ndërkombëtar e ka dënuar njëzëri?

Opozita joparlamentare dhe sidomos lideri i demokratëve Lulzim Basha, nga përdorimi i dhunës në protesta, humbasin pikë në reputacionin e tyre, sidomos para faktorit ndërkombëtar. Por duket se në këtë pikë që ndodhet kriza politike, në frontin opozitar këtë ulje reputacioni në sy të ndërkombëtarëve e cilësojnë si një humbje të vogël dhe të domosdoshme për të arritur një fitore të madhe.

Në kampin opozitar është duke fituar terren ideja se nëpërmjet përdorimit të dhunës i hapet rruga një skenari të mundshëm që po qarkullon kohët e fundit, fillimisht nën zë nëpër qarqet politike e mediatike dhe kohët e fundit edhe publikisht nëpërmjet disa debateve mediatike. Bëhet fjalë për mundësinë e shtyrjes së zgjedhjeve vendore nga ana e Presidentit të Republikës. Pra që Ilir Meta të anulojë dekretin e tij presidencial për caktimin e datës 30 qershor dhe caktimin e një date të re, mbase diku nga muaji shtator i këtij viti. Pavarësisht se kjo mund të jetë antikushtetuese, në mungesë të Gjykatës Kushtetuese maxhoranca nuk ka mundësi kundërshtimi ndaj këtij vendimi të Presidentit, nëse ai merret.

Kështu një skenar i mundshëm është që opozita joparlamentare nëpëmjet përshkallëzimit të dhunës në protestën e sotme të synojë të arrijë të "detyrojë" Presidentin Meta që të vendosë për shtyrjen e datës së zgjedhje vendore. Përballë një situate që ka kohë që është e tensionuar dhe që degjeneron në dhunë, atëhere Presidenti i Republikës mund të ndërhyjë duke përdorur argumentin e shmangies së një konflikti të mundshëm, duke anuluar dekretin e tij presidencial për zhvillimin e zgjedhjeve më 30 qershor dhe shtyrjen e tyre.

Nëse ndodh diçka e tillë opozita, edhe pse me një kosto të madhe, fiton kohë për ta dalë nga rruga ku është futur, fillimisht me djegien e mandateve parlamentare dhe më pas me vendimin për bojkotimin e zgjedhjeve vendore.

Por sërisht do të jetë thjesht fitim kohe, pasi edhe në rast se zgjedhjet vendore shtyhen, shtatori vjen shpejt dhe Rama me shumë gjasa do të vazhdojë të jetë kryeministër.

Në këtë rast çfarë vendimi do të marrin Basha e Kryemadhi? A do t'ia vlejë përdorimi i dhunës në protesta? A do t'ia vlejë dëmtimi i disa policëve apo edhe protestuesve, apo largqoftë ndonjë humbje jete?

KREU I LSI-së

Kryemadhi: Jemi përballë rrënojës që kërkon oksigjen, t'i heqim prizën



Për herë të parë pas deklaratës se mungoi në protestën e shkuar se i ishte nënshtruar një operacioni, kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi doli dje në një konferencë për mediat ku akuzoi kryeministrin Edi Rama se është i kapur nga krimi. Ajo tha se beteja e protestuesve nuk është me uniformat e policisë dhe godinat por me qeverinë. Ndryshe nga lideri demokrat Lulzim Basha i cili e quajti protestën e sotme bashkim kombëtar, Kryemadhi tha se protesta duhet të jetë paqësore. "Protesta e nesërme është e të gjithë qytetarëve të Shqipërisë. Sot qytetarët nuk kanë ndërmend të gjejnë armikun e klasës por të garantojmë mirëqenien e fëmijëve të tyre, të garantojnë një ekonomi të fortë. Protesta e nesërme është e rëndësishme sepse pjesëmarrja më e madhe do të shkundë nga themelet atë mentalitet të kalbur që ka ngelur në mendjen e kryeministrit të ikur. Beteja jonë nesër nuk është as me uniformat e policisë dhe as me godinat. Cdo dhunë ndaj godinave paguhet me taksat tona dhe e viktimizon Edi Ramën. Beteja jonë është me krimin e organizuar i cili ka fytyrën dhe krimin e Edi Ramës. Largimi i tij do sjellë edhe fundin e tranzicionit. Më 27 qershor të 2017, dy ditë pas zgjedhje Vasili mbajti një konferencë për shtyp ku denoncoi krimin e organizuar. Sot ja ku jemi me një kosto shumë të madhe përballë një rrënoje në grahmat e saj të fundit që kërkon oksigjen. Po ne kemi vendosur do t'ia heqim prizën. Ai sot punon për pesë veta. Ai rriti koston e jetesës por rrogat i la aty ku ishin. Duhet të jemi të gjitha në protestë. Kushdo nga ne që bën kompromis në kurriz të shqiptarëve nuk do jetë gjë tjetër veçse tradhti kombëtare. Vetëm një protestë me të rinj dhe të reja paqësore do jetë goditja më e madhe për krimin e organizuar", tha Kryemadhi.

THIRRJE SHTETASVE AMERIKANË

Ambasada e SHBA-së: Shmangni institucionet, për një kohë të pacaktuar

Dje, një ditë përpara protestës së opozitës, Ambasada Amerikane në Shqipëri u ka bërë thirrje shtetasve të saj, që të shmangin zonat ku pritet të zhvillohet ky tubim. Në një postim të publikuar në faqen e tyre zyrtare, Ambasada, duke iu referuar protestave të kaluara, njofton qytetarët që nga ora 19:00 deri në një kohë të pacaktuar të mos kalojnë në institucionet kryesore të vendit. "Një demonstrim i madh pritet të zhvillohet pranë Zyrës së Kryeministrit më 8 qershor 2019, duke filluar rreth orës 7:00 të pasdites. Grupi synon të demonstrojë kundër qeverisë shqiptare dhe mund të lëvizë në vende të ndryshme në Tiranë. Kohëzgjatja e demonstratës së pritshme është e panjohur. Demonstrimet e kohëve të fundit kanë përfshirë dhunën. Forcat e sigurisë kanë përdorur ujë dhe gaz lotsjellës për të shpërndarë turmat.



Personeli i Ambasadës së SHBA-së dhe anëtarët e familjes janë drejtuar për të shmangur të gjitha pikat e grumbullimit dhe vendet ku demonstratat janë të pashmangshme ose në vazhdimësi. Ndërtesa e Parlamentit (Tiranë) Zyra e Kryeministrit (Tirana) Ndërtesa të tjera qeveritare (Tiranë)", shkruan Ambasada.

Mandati i dytë, nga Kampusi Universitar te projekti i Kopshtit Zoologjik

Kryeministri Rama dhe Veliaj biseduan për disa nga projektet transformuese që do të vijojnë të zbatohen edhe në 4 vitet e ardhshme në kryeqytet



Kryeministri i Edi Rama dhe kandidati i PS për Bashkinë e Tiranës, Erion Veliaj, të shoqëruar edhe nga ish-ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe deputetja e Blerina Gjylameti, e nisën ditën e djeshme me një kafe me banorët e Njësisë 10, me të cilët biseduan për disa nga projektet transformuese që do të vijojnë të zbatohen edhe në 4 vitet e ardhshme në kryeqytet. Një nga projektet më të mëdha dhe që vjen edhe si përmbushje e Paktit për Universitetin është ndërtimi i Kampusit Universitar.

Kryeministri Rama tha se projekti është në punë e sipër, ndërsa kryetari i Bashkisë së Tiranës, Veliaj shtoi se përveç kampusit të Qytetit Studenti do të bëhet edhe ai i Akademisë së Rendit. "Jemi në fazën kur po i bashkojmë të dyja projektet, edhe atë për kampusin e Akdemisë së Policisë", tha Veliaj.

Ndërkohë, kreu i qeverisë vuri theksin edhe te nevoja për ndërtimin e një Teatri të ri Kukullash modern dhe me të gjitha kushtet te zona ku sot ndodhet Garda e Republikës dhe ku do të ndërtohet edhe Biblioteka e re Kombëtare. "Aty ku duam të bëjmë Bibliotekën e re Kombëtare, aty mund të bëjmë edhe një teatër të bukur kukullash për fëmijë. Shkova një ditë me Zahon te kopshti zoologjik, aty shkoja çdo të dielë se kisha burrin e hallës që merrej me muzikë, rrija tek kabina e tij dhe e mbaj mend shumë mirë, më është fiksuar që i vogël si ka qenë, aty çdo të dielë bëhet mizë lisi dhe gjysma ngelen jashtë se nuk futen dot", tha Rama.

Veliaj tha se në 4 vitet e ardhshme një tjetër projekt është edhe ai i transformimit të Kopshtit Zoologjik dhe Botanik. Kryebashkiaku shtoi se qeverisë do t'i shkojë nga Ministria një VKM e cila do bëjë dhe kalimin e pronës te Bashkia e Tiranës, për të filluar më pas zbatimin e projektit. "Do vijë VKM që bashkon Kopshtin Zoologjik me Kopshtin Botanik, kemi edhe një dakordësi me dekanin e Shkencave të Natyrës. Ata nuk kanë fuqi që ta mbajnë, ne do të bëjmë një marrëveshje ku do të themi që Bashkia menaxhon Kopshtin Zoologjik dhe Kopshtin Botanik si një njësi e vetme. Marrëveshja do t'u japë akses të plotë atyre për nevojat e mësimore, për eksperimente biologjike, të klasave të hapura, të praktikave studentore. Por, me mirëmbajtje nga bashkia. Kemi përgatitur gjithë materialin dhe mund ta hapim garën për projektin vetëm kur të kemi pronën. E kemi ndarë në tre faza, botaniku, zoologjiku dhe lidhja mes tyre, në formë tuneli si një akuarium", u shpreh Veliaj.

Ai theksoi se një nga projektet që do prekë edhe këtë njësi është ai për çlirimin e trafikut të makinave në pjesën e Unazës së Vogël nëpërmjet kalimit të saj nën tokë, nga segmenti te Shallvaret deri te pjesa përpara sallës së seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë. "Po i tregoja kryeministrit planin që kemi për Unazën e Vogël, që ta fusim poshtë parkut, ta nxjerrim te Xhamia para Parlamentit, kështu zhduket i gjithë trafiku që futet nëpër të. Ka qenë idea e vjetër e Edit, po më në fund e kemi një koncept inxhinierik dhe e shpëton Tiranën si një gjullurdi e qendrës, edhe si trafik, edhe si ndotje", tha ai

TË DËMTUARIT NGA TËRMETI

Rama: Fond nga çdo bashki për Floqin, do t'ua bëjmë shtëpitë brenda verës

Gjatë takimit që Rama dhe Veliaj kanë patur me banorët e Njësisë Nr.10 në Tiranë, ata kanë folur edhe në lidhje me situatën në qytetin e Korçës pas tërmeteve të rëna në këtë zonë. Rama ka premtuar edhe një herë, se qeveria do të bëjë të mundur rregullimin e banesave dhe kompensimin e banorëve. Kryeministri më pas ka thënë se në ndihmat e fshatrave të prekura do të kontribuojnë edhe bashkitë socialiste. "Për Floqin do bëjmë fond solidariteti, çdo bashki do marri përsipër një shpi. Do bëjmë një llogari dhe një pjesë të fushatës nga KQZ ti fusim aty. Më mirë një shpi për ata sesa postera dhe reklama. Do ta bejmë. Ishte shumë keq ishin dëmtuar shumë. Një fëmijë i vogël qante aty. Kishte qënë shumë i fortë. Tmerr i madh. Ta fillojmë ta mbarojmë brenda verës. Ishte shumë ftohtë. Ta mbarojmë nga shtatori." ka thënë Rama.



BASHKIA E TIRANËS DO NDËRTOJË 4 SHTËPI

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dje ka mbledhur Këshillin Bashkiak në kuadër të vendimeve që pritet të miratohen nga bashkia e Tiranës. Në fjalën e tij Veliaj ka thënë se një vendim jashtë rendit të Bashkisë së Tiranës është përgjigjja ndaj kërkesës së kryeministrit Rama në lidhje me familjet e prekura nga tërmetet në Kroçë. Veliaj ka thënë se do ti përgjigjen kësaj kërkese dhe se do të kontribuojnë me ndërtimin e 4 banesave.

Shoqëria Përmbarimore "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme:

"Are", me Nr. Pasurie 213 Volum 1, Faqe 85, Zonë kadastrale 3454 me siperfaqe 2,625 m², me vendodhje Sine e Poshteme, Arras, Diber, në pronësi të Izmir Shaban Tafa dtl.20.12.1987, Shaban Imer Tafa dtl.13.06.1940 dhe Bardhe Ali Tafa dtl.17.05.1949, mbi të cilen është vënë hipotekë ne favor te "Agrokredit" Sh.a, per Shumen Leke.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 240,000 (dyqnid e dyzete mije) Leke.

Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e shoqërisë "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 21.06.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. "Pjeter Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

Shoqëria Përmbarimore "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasuritë e paluajtshme:

1. Are, me Nr. Pasurie 36 Volum 1 Faqe 36, Zonë kadastrale 2635, me siperfaqe 1750 m², me vendodhje, Mbrezhdan, Permet, në pronësi të Llazi Thoma Nasi dtl.01.10.1962 , Vjollca Muharrem Nasi dtl.20.01.1971, dhe Vitori Kiço Nasi dtl.05.05.1928.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 200,000 (dyqind mije) Leke.

2. Are, me Nr. Pasurie 269 Volum 2 Faqe 19, Zonë kadastrale 2635, me siperfaqe 549 m², me vendodhje, Mbrezhdan, Permet, në pronësi të Llazi Thoma Nasi dtl.01.10.1962, Vjollca Muharrem Nasi dtl.20.01.1971, dhe Vitori Kiço Nasi dtl.05.05.1928.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 48,000 (dyzete e tete mije) Leke.

Mbi të pasurite është vënë hipotekë ne favor te "Agrokredit" Sh.a, per Shumen 200,000 (dyqind mije) Leke.

Ankandet do të zhvillohen në ambjentet e shoqërisë "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 18.06.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. "Pjeter Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

Shoqëria Përmbarimore "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasuritë e paluajtshme:

1. Are, me Nr. Pasurie 277/1 Volum 4 Faqe 82, Zonë kadastrale 2609, me siperfaqe 2890 m², me vendodhje Mashkullore, Gjirokaster, në pronësi të Nafiz Sali Alikaj dtl.22.05.1965, Lumturi Nevruz Alikaj dtl.01.10.1975 dhe Desdemona Abedin Alikaj dtl.11.05.1940.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 400,000 (katerqind mije) Leke.

2. Are, me Nr. Pasurie 320/2 Volum 5 Faqe 163, Zonë kadastrale 2609, me siperfaqe 3644 m², me vendodhje Mashkullore, Gjirokaster, në pronësi të Nafiz Sali Alikaj dtl.22.05.1965, Lumturi Nevruz Alikaj dtl.01.10.1975 dhe Desdemona Abedin Alikaj dtl.11.05.1940.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 640,000 (gjashteqind e dyzete mije) Leke

3. Are, me Nr. Pasurie 320/3 Volum 5 Faqe 164, Zonë kadastrale 2609, me siperfaqe 1290 m², me vendodhje Mashkullore, Gjirokaster, në pronësi të Nafiz Sali Alikaj dtl.22.05.1965, Lumturi Nevruz Alikaj dtl.01.10.1975 dhe Desdemona Abedin Alikaj dtl.11.05.1940.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 280,000 (dyqind e tetedhjete mije) Leke.

Mbi pasurite është vënë hipotekë ne favor te "Agrokredit" Sh.a, per Shumen 1,000,000 (nje milion) Leke.

Ankandet do të zhvillohen në ambjentet e shoqërisë "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 18.06.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. "Pjeter Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

Shoqëria Përmbarimore "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme:

"Truall + Ndertese", me Nr. Pasurie 703 Volum 3 Faqe 203, Zonë kadastrale 3338, me siperfaqe Trualli 142,3 m², ndertese 78,6 m2, me vendodhje, Shen Vasil, Sarande, në pronësi Robert Vaso Balla dtl.05.01.1982, Kalo Thoma Balla dtl.01.11.1946 dhe Evanthia Vaso Balla dtl.13.10.1975, mbi të cilen është vënë hipotekë ne favor te "Agrokredit" Sh.a, per Shumen 2,000,000 (dy milion) Leke.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 800,000 (teteqnid mije) Leke.

Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e shoqërisë "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 10.06.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. "Pjeter Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

Rama: Opozita e bëri copë Shqipërinë me artikuj të paguar!

Rama intervistë për 'Oggi': Nëse në Shqipëri mbretëron krimi i organizuar, jemi të dytët pas Italisë

Kryeministri Edi Rama dhe kandidati i koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për kryetar të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj janë takuar dje me banorë të njësi Njësisë Administrative Nr. 10 në Tiranë, në kuadër të fushatës për zgjedhjet e 30 qershorit. Rama dhe Veliaj takimet i kanë nisur që në mëngjes pasi janë fotografuar së bashku teksa ecin qetësisht në rrugët e kryeqytetit. Ndërkohë në këtë takim kanë qenë të pranishëm edhe ish-ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe deputetja e Blerina Gjylameti. Gjatë takimit, Rama është pyetur edhe në lidhje me zgjidhjet e 30 qershorit, ku ka pohuar edhe një herë se zgjedhjet do të kryhen dhe data nuk do të ndryshojë. Më pas Rama ka 'thumbuar' edhe opozitën duke thënë se ka persona që paguajnë për të shkruar artikuj që baltosin Shqipërinë. "Hall i madh. Balta e madhe që po hedhin lartë e poshtë. Jo thjesht ne por edhe jashtë Shqipërisë paguajnë, hidh artikuj këtej, hidh andej. Në atë rast gazeta merret me gjëra të tilla, i kanë çuar e ka bërë, puna e vet. Por shumë angazhim, shumë energji. E tmerrshme. Tmerr i madh, e bënë copë Shqipërinë vetëm për..., nuk e di. Nuk e bën asnjë në botë, të gjithë kanë pasur opozitë, të gjithë kanë pasur beteja. Të gjitha vendet që kanë qenë në BE, edhe Bullgaria kishte bojkot, por morën presidencën e BE-së, 6 muaj bënë paqe politike. Më vjen keq, po asnjë shtet tjetër nuk ka fatkeqësi të ketë Saliun. Të gjithë ato që dolën nga ato historira ikën në punë të vet, ky vazhdon akoma. Bëmë në 2017 marrëveshjen. Por aq muaj sa ndenjën, gjëra të pabesueshme, budallallëqe, i paaftë, aty e kupton jepja dhe njëherë ta bëjnë nga e para. Si luani njësoj, që nga mishngrënës, vegjetarian dhe fol me vete, është tmerr i madh", ka thënë Rama.



Rama

"Tmerr i madh, e bënë copë Shqipërinë vetëm për..., nuk e di. Nuk e bën asnjë në botë, të gjithë kanë pasur opozitë, të gjithë kanë pasur beteja. Të gjitha vendet që kanë qenë në BE, edhe Bullgaria kishte bojkot, por morën presidencën e BE-së, 6 muaj bënë paqe politike".

RAMA, INTERVISTË PËR 'OGGI'

Kryeministri Rama ka dhënë së fundmi një intervistë për revistën italiane "Oggi" ku flet për Shqipërinë dhe zhvillimet e fundit në vend. Gazetarja italiane Maria Giuseppina Buonanno, ka intervistuar kryeministrin Rama në zyrën e tij në Tiranë e pyetja e saj e parë qe: Si do të zgjidhet kriza politike në vend? "Të shohim", thotë Rama e për gazetaren italiane, kryeministri shqiptar ka vështrimin e dikujt që është i mbushur me mendime, por që i shikon nga njëmijë dritare. "Nga shkurti i kaluar, shkruan revista italiane, PD e cila është parti e qendrës së djathë ka organizuar protesta në rrugë kundër Ramës duke kërkuar dorëheqjen e tij për korrupsion, si dhe zgjedhje të reja politike. Tashmë shumë presin zgjedhjet vendore të 30 qershorit, që e djathta i ka bojkotuar. Por ata i mbajnë shpresat tek turizmi." "Në 2013 turistët në Shqipëri ishin 2,3 milionë, në 2018 ishin 6 milionë e ne synojmë të arrijmë në 10 milionë gjatë 5 viteve , thotë kryeministri Rama, duke shtuar se dhe pse Shqipërisë i mungon Leonardo e Ghioto, ka shumë histori e kulturë për t'u zbuluar e rrëfyer."

TURIZMI

"Shqipëria, shkruan media italiane, ka më pak se 3 milionë banorë por ka parqe arkeologjike si Apollonia e Butrinti. Në Shqipëri ekzistojnë gjurmë urbanistike të arkitekturës italiane lindur nga aleanca e Shqipërisë me Italinë fashiste, ekzistojnë bunkerë që dëshmojnë sundimin e vendit nga regjimi komunist, disa thonë se janë rreth 175 mijë e disa të tjerë mbi 700 mijë. Shqipëria ka detin e brigjet e frekuentuar shumë nga turistët kosovarë, polakë e italianë. Vetëm në vitin e shkuar Shqipërinë e kanë vizituar rreth 436 mijë italianë e mbi 60 % në krahasim me vitet e fundit. Ndërsa në 2018 numri i turistëve u rrit me 15.8% më shumë në krahisim me 2017". "Shqipëria ku mungojnë rrjetet hekurudhore e autostradat, po ndjek një rrugë zhvillmi bazuar tek turizmi." "Shqipëria rrëfen Rama për revistën italiane, i ngjan Italisë së viteve '60. Ejani, thotë ai, vizitoni Shqipërinë e do të gjeni gjyshërit tuaj, ashtu siç ata dikur shihmi me shpresë të ardhmen. E ndoshta dhe për të parë se sa të aftë jemi dhe ne për të shkatërruar peizazhin, ashtu si dhe ju dikur", shton me një ironi të hidhur kreu i qeverisë shqiptare. E si për të justifikuar se disa gabime janë të pashmangshme, nënvizon revista italiane Oggi, kryeministri shqiptar shton se "në një proces modernizimi jo gjithçka funksionon gjithmonë si duhet". "Turizmi, thotë Rama, sjell punë, njohuri e hapje ndaj botës, e ne kemi shumë për të mësuar e për të kopjuar nga Italia. Ne ndjehemi italianë". "Në Shqipëri ka rreth 20 mijë italianë sipërmarrës e studentë, shton Rama, ndërsa gazetarja italiane korrigjon duke informuar se sipas regjistrit të Ministrisë së jashtme italiane në Shqipëri jetojnë vetëm 2500 italianë." Për media italiane kryeministri shqiptar kujton se në Shqipëri ekziston taksa e sheshtë vetëm 15% ashtu si në Itali ka propozuar dhe Salvini, prandaj është një vend i hapur për investitorët e huaj. "Shqipëria , nënvizon Rama ka ëndërr Evropën. Për ne, thotë ai, është i vetmi vend paqe, e ne jemi në zemër të saj pa qenë pjesë".

INTEGRIMI

Për kryeministrin shqiptar Evropa duhet të ndryshoj e të reformohet por nuk duhet braktisur. Lindja e BE ishte një projekt futurist, tha ai. "Në Shqipëri, thotë Edi Rama. të gjithë flasin italisht e kanë mësuar nga televizioni përgjatë viteve të komunizmit ku u vranë 7 mijë persona, u internuan mbi 40 mijë, ku u shkatërruan 2500 kisha e xhamia. Pas rënies së këtij regjimi nisi eksodi i madh i shqiptarëve dhe drejt Italisë e ku sot jetojnë 500 mijë shqiptarë." Në mbyllje të intervistës së tij kryeministri shqiptar thekson "Shpesh flitet për Shqipërinë si vendi ku mbretëron kr.imi i organizuar. Por ky është një vizion që ka prekur e prek dhe Italinë. E atëherë ne jemi të dytët, vijmë menjëherë pas jush". "E thotë si batutë, komenton gazetarja italiane, e të gjithë qeshin dhe italianët e pranishëm. Ndërsa Rama largohet me atë vështrim që hap dritaret ndër mendimet e tij të shpeshta, shqetësime e një të ardhme me ngjyra të ndezura.



Parla Edi Rama, il premier albanese: "Ci sentiamo molto italiani e vi copiamo"

06 giugno 2019

Condividi

Il leader socialista guida il Paese dal 2013. E invita a investire a Tirana e dintorni. "Perché noi la flat tax di Salvini ce l'abbiamo già", dice

Poco più di dieci passi e una domanda: come si risolverà la crisi politica in Albania? Il premier socialista Edi Rama, che guida il Paese dal 2013, guarda chi lo rincorre nel suo ufficio e accenna un «vedremo». Ha lo sguardo di chi sovrappone pensieri e li guarda da mille finestre. Se è preoccupato, non lo confessa ed entra nel suo studio, che si trova accanto al salone di rappresentanza del Palazzo del Governo albanese, a Tirana. Alla fine di un incontro dedicato al turismo, il premier, che è anche pittore e ha fatto mostre in Italia, a New York, a Berlino, ha altri appuntamenti istituzionali, ma ci tiene a mostrare il suo ufficio-atelier. Sulle pareti sono stati riprodotti i suoi disegni coloratissimi, quelli che definisce scarabacchi: wallpaper una


Berisha-Basha

"Më vjen keq, po asnjë shtet tjetër nuk ka fatkeqësi të ketë Saliun. Të gjithë ato që dolën nga ato historira ikën në punë të vet, ky vazhdon akoma. Bëmë në 2017 marrëveshjen. Por aq muaj sa ndenjën, gjëra të pabesueshme, budallallëqe, i paaftë".

CAKAJ:

"Shqipëria dëshiron t'i hapë negociatat sot dhe jo nesër!"

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, ka folur për gazetën më të madhe Holandeze Het Financieele Dagblad. Cakaj thekson për median holandeze se Shqipëria dëshiron të nisë negociatat me Brukselin për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian sot dhe jo nesër. Duke vene theksin tek reforma ne drejtesi, Cakaj thekson se "Ne jemi i vetmi vend në të gjithë rajonin që ka krijuar një trupë të tillë ndërkombëtare".



"Ministri shqiptar duke u ndalur tek reforma në drejtësi, si maja e sukseseve të Shqipërisë. Katër vite më parë Shqipëria filloi një rinovim të plotë të sistemit të saj gjyqësor. Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët po testohen për të parë nëse ata punojnë me integritet. Kjo po bëhet nën mbikëqyrjen e një institucioni të ri, të përbërë nga gjyqtarë dhe prokurorë nga vendet anëtare të BE, përfshirë dy avokatë nga Holanda. "Ne jemi i vetmi vend në të gjithë rajonin që ka krijuar një trupë të tillë ndërkombëtare", thekson ndër të tjera gazeta holandeze", thekson media holandeze. 'Thembra tjetër tradicionale e Akilit për Shqipërinë është korrupsioni i përhapur dhe krimi i organizuar, por Cakaj thotë se Tirana mbetet entuziaste. Për shembull, qeveria ka ngritur një grup pune për të frenuar korrupsionin. Përveç kësaj, një agjenci e re kombëtare kërkimore do të shqyrtojë se cilët liderë politikë shqiptarë, sipërmarrës apo drejtues kanë lidhje me mafian'. Problemi është se këto dy organe nuk janë ende funksionale, por sipas Cakajt kjo është një çështje kohe. "Ne kemi gjetur tashmë emrat e njerëzve që do të punojnë atje. Por ata, së pari, duhet të kalojnë testin e vlerësimit", thotë ministri. "Ne gjithashtu kemi ndërmarrë hapa në këtë fushë, i kemi mbajtur të gjitha premtimet ndaj Komisionit Europian".

BSA
Bailiff Services Albania

NJOFTIM

Shoqëria Përmbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-1, të pasurisë së paluajtshme në pronësi të z.Elton Mezini, lënë garanci për "ABI Bank" sh.a

-NË DATË 10.06.2019 ORA 16:00.
-"Njesi" Pasuri nr. 9/224-N2, Vol.12, Fq.6, ZK.8370, me sip.72.3 m² me adrese Tirane, ne pronesi te z.Elton Mezini, me çmimin fillestar 52,080 Euro.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com



Afati
Projekti përfshin makinat dhe jahtet apo gomonet e bllokuara, të sekuestruara, të konfiskuara apo të ndaluara për shkaqe të ndryshme nga organet e abatimit të ligjit deri në fund të vitit 2016

Prova
Kusht për kalimin nga ruajtja në Polici është që mjetet të mos kenë më statusin juridik, pra nuk përdoren si provë materiale. Ato kalojnë dhe do të administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për procedura të tjera

Qeveria: Ja si do të procedohet me makinat dhe gomonet nën sekuestër

Nisma ligjore prek mjetet e bllokuara deri në fund të vitit 2016

Qeveria ka përgatitur një projektligj lidhur me trajtimin e automjeteve dhe mjeteve lundruese që janë sekuestruar apo konfiskuar nga organet e ruajtjes së rendit apo organet e tjera ligjzbatuese. Projekti është hedhur në diskutim me grupet e interesit. Ai përfshin makinat dhe jahtet apo gomonet e bllokuara, të sekuestruara, të konfiskuara apo të ndaluara për shkaqe të ndryshme deri në fund të vitit 2016.

MJETET RRUGORE

Qeveria propozon që automjetet e regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit deri në datën 31.12.2016, të cilat nuk kanë statusin juridik, pra nuk përdoren si provë materiale, do të kalojnë dhe do të administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Ndërsa ato makina, dhe mjete të tjera rrugore, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare (me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi nga një shtet i huaj) dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara si më sipër, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, kalojnë dhe administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

MJETET LUNDRUESE

E njejta procedurë propozohet edhe për mjetet e ndryshme lundruese. Mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe me certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit deri në datën 31.12.2016, të cilat nuk kanë statusin juridik, (provë materiale), do të kalojnë dhe do të administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Mjetet lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare (me ose pa leje lundrimi nga një shtet i huaj) dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara sa më sipër, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, do të kalojnë dhe do të administrohen nga Rezervat Materiale të Shtetit, për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, sipas administrimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

PROCEDURAT

Kalimi i këtyre mjeteve nga mjediset e drejtorive të Policisë Vendore përkatëse dhe ato të Policisë Kufitare dhe Migracionit bëhet pranë mjediseve të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, që korrespondon me territorin respektiv, së bashku me dokumentacionin shoqërues të mjetit. Procedurat e kalimit dhe të çregjistrimit rregullohen me Udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrit tëInfrastrukturës dhe Energjisë.

Të ardhurat që gjenerohen nga procedura të tilla, në përputhje me ligjin, do të kalojnë në favor të buxhetin e shtetit. Ngarkohen të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të kësaj pike Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Mbrojtjes.

Ligji mendohet të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Investitorët
TIRANE

Monopolet dhe korrupsioni, shqetësimi kryesor për biznesin e huaj

Të bësh biznes në Shqipëri mbetet një sfidë më vete. Investitorët e huaj që operojnë në vend në sektorë të rëndësishëm si banka, industri nxjerrëse, telekomunikacion, etj vlerësojnë se situata ekonomike në 6 muajt e parë të këtij viti ka qenë e pafavorshme. Vlerësimi negativ nis nga zero dhe ai më pozitiv është 100, por bizneset e huaja e kanë vlerësuar me 39 pikë klimën për të bërë biznes në vendin tonë.

Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA) ka prezantuar dje rezultatet e vëzhgimit për mjedisin e biznesit 2019, të zhvilluar me anëtarët e saj, që janë sipërmarrjet më të rëndësishme në vend, si banka, kompani që veprojnë në fushën e industrisë, naftës, telekomunikacionit, energjisë, konsulencës etj.


Paralelisht me këtë situatë, bizneset e pyetura shpresojnë se në periudhën e dytë të vitit pritshmëritë shënojnë një përmirësim të lehtë, por sërish ato mbeten poshtë mesatares.

Shkak për këtë vlerësim negativ, nuk lidhen vetëm me klimën gjatë një viti elektoral. Katër janë problemet kryesore që shqetësojnë sipërmarrësit e huaj. Në vend të parë janë monopolet në disa tregje, më pas vjen korrupsioni, të dy këto fenomene vlerësohen me 68 pikë. Më pas vijnë burokracitë shtetërore me 64 pikë dhe në vend të katërt renditet informaliteti.

Përtej katër pengesave kryesore që ndikojnë në ekonomi, sipërmarrësit e huaj vlerësojnë edhe disa nga fushat që kanë shënuar përkeqësim të klimës. Politika vlerësohet si një fushë që ka shënuar përkeqësim, për shkak të krizës që ka përfshirë vendin prej 4 muajsh. Përkeqësim kanë shënuar edhe procedurat qeveritare të cilat behën pa transparencë, por edhe ato të prokurimi publik.

Pak kohë më parë edhe shoqata e investitorëve gjermanë në sondazhin e kryer vlerësoi se klima ekonomike nuk është aspak optimiste.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, e pranishme gjatë prezantimit të rezultateve të mjedisit të biznesit, tha se qeveria është e hapur për dialog të vazhdueshëm me sipërmarrjet. Ajo shtoi që burokracitë janë ulur ndjeshëm, siç konfirmohet dhe në raportin e "Të bësh biznes" të Bankës Botërore. Denaj tha se është e vërtetë që janë larguar 2-3 kompani të huaja, por sipas të dhënave të 5-mujorit nga Qendra Kombëtare e Biznesit janë hapur 89 biznese të reja me aksionerë të huaj.




Perspektiva
Investitorët e huaj që operojnë në Shqipëri vlerësojnë se situata ekonomike në 6 muajt e parë të këtij viti ka qenë e pafavorshme, por për periudhën e dytë të vitit pritshmëritë shënojnë përmirësim të lehtë

Më tej, Denaj prezantoi projektin e Fiskalizimit, të cilin Ministria e Financave e ka nisur këtë vit, me synimin që në vitin '20-'21 të gjitha pagesat të mund të kryhen në mënyrë elektronike. Kjo do të kontribojë në një ulje shumë të ndjeshme të informalitetit. Ajo u bëri të ditur bizneseve rezultatet e reformave të ndërmarra nga qeveria, si ato që kanë të bëjnë me reformën e derregullimit, me licencat të cilat sot jepen 99% online. Denaj i ftoi anëtarët e shoqatës të vizitonin Shkollat Profesionale dhe Zyrat e Punës në çdo vend ku ata operojnë, në mënyrë që të ndërmjetësojnë më mirë nevojat e të dyja palëve, të punëkërkuesve dhe të punëdhënësve.

Digjen dy makina të kryetares së PD në komunën e Ulzës

Mjetet e djegura në pronësi të Gjelina Kalthit: "Nuk e mbledh dot veten, vetëm krimi po zhvillohet"



Një ngjarje e rëndë ka ndodhur orët e para të mëngjesit të djeshëm në qytezën e Ulzës. Dy makinat në pronësi të kryetares së PD-së, Ulëz njëkohësisht administratore e kësaj njësie për Bashkinë Mat, Gjelina Kalthi janë shkrumbuar nga flakët. Ngjarja ka ndodhur pranë banesës së saj, ku dy makinat ishin të parkuara. Për këtë ngjarje ende nuk dihen rrethanat, por familja mohon që të ketë konflikte. Gjelina Kalthi pretendon se makinat në pronësi të saj janë djegur qëllimisht për shkak të angazhimeve të saj me Partinë Demokratike dhe të pjesëmarrjes në protestat e thirrura nga opozita.

DËSHMIA E KALTHIT

"Isha për darkë tek të afërmit në 12 erdha dhe parkova makinat ne parkimin e qytetit. Nga ora 2:30 na njoftojnë komshinjtë se u janë djegur makinat. Nuk e mbledh dot veten. Vetëm krimi që po zhvillohet. Jam administratore, jam edhe kryetare e PD-së, por skam konflikte për shkak të detyrës me dijeninë time të paktën. Kjo ndodh një ditë para protestës. Dyshoj, se unë i kam marrë me makinë në protestë. dy makinat e mija në çdo protestë që ka organizuar PD-ja kam marrë 10 persona dhe i kam çuar në protestë. Personalisht, familjarisht dhe për shkak të detyrës nuk kam asnjë lloj konfliktin. Asnjë lloj konflikti. Por kjo flet qartë vetë, pasi një ditë para protestës më digjen makinat. Edhe bashkëshorti ka qenë anëtar i kryesisë së PD-së. duan me na demoralizuar. Mua jo të më djegin makinën por të më djegin edhe shtëpinë, nuk tërhiqem Është dëm ekonomik por moralin nuk ma ulin dot. Edhe mund të më vrasin. Nesër me shpenzimet e mia do sponsorizoj të çoj njerëz në protestë" është shprehur Gjelina Kalthi.

BASHKËSHORTI

Makinat e djegura kanë qenë larg njëra tjetrës ndërsa në vendin e ngjarjes ka patur edhe makina të tjera por zjarri ka përfshirë vetëm dy makinat e administratores së njësisë së Ulzës në Bashkinë e Matit. Ndërkohë bashkëshorti i saj, Fran Kalthi është përgjegjës i një kompanie të Policisë Private gjithashtu edhe ish-anëtar i kryesisë së PD-së në Ulëz, por mohon që të ketë konflikte që mund të kenë sjellë djegien e makinave. Policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe po heton për shkaqet e djegies së makinave si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

PROCESI GJYQËSOR

Prokurori në "ankthin" e vettingut,shtyhet seanca e për "dosjen e 613 kg kokainë"





Ka nisur me shtyrje seanca e parë gjyqësore për dosjen e 613 kg kokainë që u kapën në Maminas. Seanca është shtyrë, pasi prokurori që po heton dosjen Edvin Kondili, i cili është kandidat edhe për në SPAK, dje doli para vettingut ndërsa sot pret përgjigjen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nëse do ta kalojë apo jo. Hetimet për këtë dosje janë ende të hapura nëse ka persona të tjerë të përfshirë në rrjetin e trafikut të kokainës nga Amerika Latine. Deri tani janë të arrestuar vetëm dy persona, Armando Pezakun dhe Donaldo Lushajn. Avokatët e shoferit të kamionit dhe te administratorit të kompanisë "Arbi Garden" të Arbër Cekajt kanë kërkuar lirimin e tyre. Pas gjetjes së 613 kilogramëve kokainë në 27 shkurt të 2018 në kontenierin me banane që erdhi nga Amerika Latine, Prokuroria e Krimeve të Rënda arrestoi shoferin e kamionit si dhe menaxherin e firmës "Arbi Garden", të cilët janë shprehur se nuk kishin dijeni mbi drogën e fshehur në dyshemenë e dyfishtë të kontenierit. Ndërkohë që Arbër Çekaj ndodhet në Gjermani, ku ka kërkuar azil politik, por që nuk është pranuar, ndërsa autoritetet shqiptare janë në pritje të ekstradimit.

Kamëz

18-vjeçarja plagos me thikë pas sherrit kunatin e dehur



Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në Kamëz, në afërsi të zonës njohur si "Kodra e Kuqe" në Paskuqan, ku një 18-vjeçare ka plagosur me thikë vëllain e bashkëshortit të saj. Ngjarja ka ndodhur në banesë, pas një sherri mes 18-vjeçares, Gj.Metallari dhe kunatit të saj Arjan Metallari, 40 vjeç. Në debat e sipër 18-vjeçarja ka plagosur me thikë Arjan Metallarin dhe si pasojë e plagëve ky i fundit është dërguar në spitalin e Traumës në Tiranë dhe aktualisht mësohet se është jashtë rrezikut për jetën. 18-vjeçarja ka një foshnje dy muajshe, ndërsa pas ngjarjes ajo është liruar për tu hetuar në gjendje të lirë. Sipas informacioneve paraprake të policisë, nëna e re ka vepruar në kushtet e vetëmbrojtjes, pasi kunati i saj ishte i dehur. Kunati 40 vjeçar ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë policia thotë po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe rrethanat që çuan në plagosje.

Burgu Peqinit

Arrestohen 6 policë, merrnin lekë dhe celularë të paraburgosurve

Ditën e djeshme, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, arrestuan në flagrancë tre punonjës në burgun e Peqinit, efektivë të angazhuar për sigurinë gjatë shoqërimit të të paraburgosurve për në gjykatë. Arrestimi i tyre u bë për shkak se gjatë shoqërimit të të paraburgosurve në gjykatë kanë mbajtur telefona celularë dhe vlera monetare me vete, veprim ky që bie në kundërshtim me skemën e sigurisë. Në pranga ranë F.K, J.C, L.C, A.T, B.K, Y.P, të gjithë me detyrë punonjës i rolit bazë, grup i sigurisë dhe shoqërimit pranë IEVP Peqin. Në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje, rezultoi se punonjësit e burgut anë konsumuar veprën penale "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim".



REPUBLIKA E SHQIPERISE

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

DREJTORIA JURIDIKE DHE E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

NJOFTIM

Me Vendimin nr. 88, datë 31.05.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur fillimin e procedurave për miratimin e "Propozimit të të gjithë OST-ve, për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015 që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve".

Të gjithë personat, shoqatat, institucionet, që mendojnë se kanë interes mbi këtë çështje, ftohen të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit.

Draftin e sipërcituar, mund ta gjeni në faqen tonë të web-it: www.ere.gov.al në seksionin Konsultime.

Adresa: Blvd "Bajram Curri" Rr. Viktor Eftimiu Tiranë, E-mail erealb@ere.gov.al www.ere.gov.al
Tel/Fax +355 42 222 963, Tel +355 42 236 880

Futi në Shqipëri 54 makina të shtrenjta pa zhdoganuar, koka dhe 4 policë në burg

Informacioni erdhi nga Franca dhe drejtoria e doganave, që tregonte kontrabandën e makinave



Prokuroria e Tiranës pas sinjalizimit nga autoritetet franceze në bashkëpunim me Drejtorinë e Doganave dhe SHÇBA-në ka zbuluar një rast të kontrabandës së automjeteve ku ishin të përfshirë edhe 10 punonjës policie nga të cilët 4 u arrestuan dhe 6 të tjerë janë pezulluar. Koka e trafikut sipas prokurores së cështjes, Mirela Cano ishte Arben Grabovari, i cili është arrestuar në muajin prill. Pas arrestimit të tij në pikën e Qafë Botës ku tentoi të hynte duke përdorur një pasaportë greke u zbulua e gjithë skema. Por si funksionon te skema? Prokurorja sqaroi se koka e kontrabandës ishte Arben Grabovari i cili sipas saj ka futur në Shqipëri 54 makina (relativisht të shtrenjta) gjatë gjithë herëve që është futur në Shqipëri në rrugë tokësore. Nga këto makina vetëm pesë janë zhdoganuar, ndërsa të tjerat jo duke u hedhur në qarkullim. Disa prej tyre dyshohet se janë përdorur edhe në ngjarje kriminale, ndërsa dëmi që i është shkaktuar shtetit nga kontrabanda është 16 mln lekë. Sipas prokurores katër efektivët e arrestuar dje në "Qafë-Botë", por edhe gjashtë të tjerët që janë pezulluar në Kapshticë janë përfshirë në skemën e kontrabandës. Punonjësit e policisë kufitare sipas prokurores në 19 raste nuk kanë pasqyruar numrin e shasisë duke i bërë të paidentifkueshme duke u shënuar vetëm autoveturë. Pesë policët e arrestuar janë Thanas Gjika, Nazif Lama, Klemend Çani dhe Shpëtim Gaziaj.

INFORMACIONI ERDHI NGA FRANCA

Drejtuesja e Prokurorisë së Tiranës, Elisabeta Imeraj tha se punonjësit e policisë janë përfshirë në skemën kriminale. "Kanë dalë në pah subjektet kriminale që në formë kontrabande sjellin mjete të ndryshme pa respektuar rregullat. Pjesë e kësaj veprimtarie janë edhe punonjësit e policisë duke shpërdoruar detyrën, pasi nuk kanë reaguar duke u bërë pjesë e veprimtarisë kriminale. Informacioni ka ardhur në kohë reale nga drejtoria e doganave dhe autoritetet franceze" tha ajo. Ndërsa prokurorja e cështjes Mirela Cano gjatë gjatë fjalës së saj tregoi skemën si u futën makinat dhe si funksionon te rrjeti. "Dua të sqaroj që prokuroria e Tiranës duke marrë shkas nga autoritetet franceze dhe doganore shqiptare regjistroi procedimin për kontrabandë në ngarkim të Arben Grabovarit. Në Prill të 2019 ky person duke hyrë në Qafë Botë ka përdor një pasaportë si shtetas grek, po hetohet në arrest me burg. Gjatë hetimit rezultoi se nga 2017-2019 në prill ka hyrë 53 herë me mjete tokësore me makina të ndryshme me lejim të përkohshëm me shmangie të detyrimeve 4.5 mln lekë, pasi ka futur 54 makina. Nga mjetet ka zhdoganuar vetëm 5 prej tyre.

MAKINAT TË PA ZHDOGANUARA

"Makinat nuk janë zhdoganuar dhe janë hedhur në qarkullim duke krijuar mundësi për ti përdorur edhe për qëllime të tjera. Në 19 raste policët kufitarë nuk kanë pasqyruar numrin e shasisë duke i bërë të paidentifkueshme duke u shënuar vetëm autoveturë. Po hetohet për identifikimin pasi makinat mund të jenë përdorur në ngjarje kriminale. Arben Grabovari ka kryer zhdoganimet në pika të ndryshme, Kapshticë, Qafë Botë dhe Tre Urat. Policët kufitarë e kanë lejuar të kalojë pa kryer procedurën përkatëse. Po hetohet për shpërdorim detyrë 10 punonjës policie, 4 janë në burg nga Qafë Bota, ndërsa 6 të tjerë janë pezulluar nga Kapshtica dhe Tre Urat. Ka edhe punonjës të tjerë të përfshirë që po hetohen" tha ajo.



KËRKOHEJ NGA INTERPOL

I premtoi Kanadanë, por e braktisi në Republikën Domenikane, kapet shqiptari

Dy shqiptarë janë arrestuar mesditën e djeshme në Angli dhe Belgjikë nga Interpol, pasi ishin në kërkim ndërkombëtar për krime në fushën e krimit ekonomik e financiar. Në pranga ka rënë edhe Kreshnik Kule, 35 vjeç. Ai ishte i dënuar me 10 vjet burg pasi kishte mashtruar një person se do të dërgonte në Kanada atë së bashku me fmiljen. Historia e tij është shumë e njohur, pasi Kule i kishte marrë këtij personit 30 mijë euro për ta dërguar deri në Kanadanë e largët, por e "braktisi" në Republikën Domenikane. Në pasaportë i kishin vënë një vizë për në Republikën Domenikane që sipas të akuzuarve do të shërbente si vend transit. Në fillim ata kanë udhëtuar drejt Turqisë dhe më pas kanë fluturuar për në Republikën Domenikane. Aty Kule dhe A.C. kanë qëndruar gati 1 muaj. Gjatë kësaj kohe ka mbërritur në këtë vend edhe babai i të pandehurit dhe një bullgar më iniciale i identifikuar si P. Dimitro. Qëndrimi në Republikën Domenikane zgjati edhe 2 muaj të tjerë me premtimet se do të niseshin dita ditës në Kanada. Pasi nuk e kanë realizuar premtimin, Kule është larguar duke e lënë A.S. vetëm me shtetasin bullgar, që është larguar disa ditë më pas. I mbetur vetëm, kallëzuesi, pas peripecish të shumta ka mundur të kthehet sërish në Shqipëri ku bëri denoncimin. Gjithashtu, në pranga ka rënë fieraku 40 vjeçar, me inicialet S.P.. Ai ishte në kërkim pasi në 2018 ishte dënuar nga Gjykata për veprat penale "Falsifikim monedhash", "Falsifikim i dokumenteve" dhe "Falsifikim i letërnjoftimeve, ose vizave".

PIPER, VAJ, ÇAJ DHE

Majdanoz AKU bllokon 5.6 ton produkte në Kapshticë dhe i kthen sërish në Turqi

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bllokuar dhe kthyer mbrapsht në Kapshticë 5636 kg produkte ushqimore të ndryshme ullinj të shtypur, vaj susami, allvasi, lëng shege, gjethe bimore çaji, vaj ulliri, thjerrëza, kamomil, trumzë jeshile, çaj dhe përzierje bimësh, rrënjë kambal, piper i zi, tuberet karafil, kimnone e coptuar, ginger pluhur, majdanoz i thatë, qiqra, kripë kineze, limon i thatë, thjerëza, çaj etj. Produktet vinin nga Turqia nga subjekti FAEK JABER, me qëllim tregtimin në Shqipëri. AKU thotë se nga kontrolli i dokumentacionit përkatës u konstatua se subjekti nuk disponon te raport-analizën e produkteve, çka përbën mospërmbushje të kërkesave ligjore të sigurisë ushqimore. Në këto kushte, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vendosi të ndalojë hyrjen e mallrave ushqimore në Shqipëri dhe i dha subjektit 7 ditë kohë të plotësojë mangësitë në dokumentacionin shoqërues të mallit. Me kalimin e këtij afati kohor dhe në kushtet kur subjekti nuk plotësoi mangësitë në dokumentacionin shoqërues të mallit, AKU



vendosi kthimin në vendin e origjinës për ngarkesën e produkteve prej 5636 kg.

Ngjarja

Plagoset me thikë gjatë një sherri 25-vjeçari në Tiranë

Një 25-vjeçar është plagosur me thikë në Tiranë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në rrugën "Frosina Plaku". Plagosja ka ardhur pas një konflikti të ndodhur mes dy personave ku E.K ka nxjerrë thikën dhe ka qëlluar personin S.GJ. Ky i fundit është dërguar me urgjencë në spitalin e Traumës në Tiranë dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe po heton për rrethanat e plagosjes si dhe kapjen e autorit E.K.




Projekti i rikonstruksionit të godinës ekzistuese të AQSHSH


Projekti për zgjerimin e vendruajtjes së arkivave në Shkozë

Ardit Bido: Nga Tirana në Shkozë, si do të jenë dy godinat e Arkivës së Shtetit

Drejtori i Përgjithshëm i institucionit prezanton për herë të parë dy projekte të mëdha që lidhen me krijimin e godinës së re dhe rikonstruksionin e godinës aktuale të AQSHSH

Dhurata Hamzai
TIRANE

Në 70-vjetorin e themelimit të Arkivit Qendror të Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm, Ardit Bido, ka bërë publike dy projekte të mëdha që lidhen me krijimin e godinës së re dhe rikonstruksionin e godinës aktuale të këtij institucioni.

Projekti u prezantuan për herë të parë në mjediset e Arkivës së Shtetit gjatë festës së 70-vjetorit, ku të ftuar të veçantë, studiues, historianë dhe punonjës të arkivave në vite u mblodhën për të rikujtuar historikun e krijimit dhe për të diskutuar për të funksionin dhe të ardhmen e këtij institucioni.

Prezantimi i dy projekteve u bë së bashku me Drejtorin e Arkivit të Kosovës, Ramë Manaj, dhe Drejtoreshën e Arkivit të MPJ, Pranvera Dibra. Shfaqja e dokumentarit, e bërë enkas për 70-vjetorin e krijimit të Arkivit Qendror Shtetëror, u ndoq me kuriozitet dhe u duartrokit nga të ftuarit. Pjesëmarrës ishin edhe Ambasadori i Republikës Arabe të Egjiptit z.Mohamed Khalil, nënkryetari i Bashkisë, Andi Seferi, drejtues të arkivave dhe muzeve të vendit, si dhe diplomatë, arkivistë, studiues dhe mjaft personalitete të tjerë.

Ardit Bida, në një intervistë për "Shqiptarja.com", flet për rëndësinë e këtij projekti qeveritar, duke përmendur edhe vlerat e thesareve arkivore që zotëron shteti shqiptar. Një projekt me vlera dhe rëndësi të veçantë për shkrimin perspektiv të historiografisë shqiptare, por edhe që do të na bëjë krenarë në botë për trashëgiminë që kemi; kështu e prezanton Bido rikontruksionin e godinës së bukur të viteve '40 të AQSHSH-së dhe modernizmin e zgjerimin e vendruajtjes së arkivave në Shkozë.

Zoti Bido, në këtë 70-vjetor të Arkivit Qendror të Shtetit, ju jeni në krye të këtij institucioni. Cilat janë perspektivat, vështirësitë e sfidat që keni kaluar e duhet të kaloni në punën tuaj?

-Është nder që të drejtosh Arkivën e Shtetit, që në momentin që e merr këtë detyrë. Fakti që jemi në jubileun e 70-të të themelimit të Arkivit Qendror të Shtetit nënkupton shumë gjëra. Nënkupton që arkivi është i konsnsoliduar tashmë. Nënkupton që arkivi ka sfida të cilat janë rezauruar tashmë prej vitesh e vitesh pune të palodhur të ish drejtuesve të institucionit dhe sidomos të arkivistëve, të cilët janë thelbi i këtij institucioni. Nënkupton, nga ana tjetër, se cilat janë sfidat e një të shekulli të ri, të cilat do na e bëjnë kërkimin arkivor shumë më të shpejtë, sepse ka pasur një ngadalësim, për shkak të një tranzicioni të zgjatur në vite, që normalisht ka lënë gjurmë edhe në Arkivin Qendror të Shtetit.

Dihet se në komunizëm historia ka kaluar nën "sitën" e interpretimit ideologjik. Mendoni ju se është koha për një rishkrim të historiografisë shqiptare?

-Historia është shkruar, po rishkruhet e do të rishkruhet. Historia nuk është diçka statike, e shkruar "në gur". Historia është dinamike dhe dinamike e bën vetë arkivi, se arkivi është materiali burimor. Kështu që një nga sfidat që kemi, është që ta bëjmë dokumentin sa më të aksesueshëm për studiuesin: ta lodhim sa më pak, të ketë kënaqësi dhe ta gjej materialin në çfarëdolloj forme. Dhe këtë besoj se e kemi realizuar në shumë pika të rëndësishme. Kujtoj se ne, që prej datës 1 korrik, do ta mbajmë hapur arkivin deri në 19.00 pasdite. Do ta mbajmë hapur edhe të shtunave, që të mos e detyrojmë studiuesin të vij në orarin e punës. Fakti që ai sot mund t'i blej online dokumentet, që mund t'i shohë në sallën e studimit disa procedura që s'janë më burokratike, por elektronike të gjitha. Kjo është një sfidë, të cilën ne e kemi përballuar dhe besoj e kemi përballuar me sukses, dhe që vjen në dobi të rishkrimit të historiografisë që është një proces i pandalshëm.

Sapo keni përfunduar projektin e restaurimit të Arkivit Qendror të Shtetit dhe atë të zgjerimit të hapësirave të reja. A e sheh me optimizëm realizimin e këtij projekti?

-Detyra jonë si institucion është që ne të bëjmë projektet, sipas standardeve dhe nevojave që ka Arkiva. Pastaj se kur do të realizohen janë çështje shumë të komplikuara. Janë çështje financimesh, çështje buxheti, çështje investimesh, të cilat nuk janë një gjë që bëhen me sot me nesër, por janë projekte që patjetër do të realizohen. Nëse nuk realizohen këtë vit, vitin tjetër. Nëse nuk realizohen sa të jem unë drejtues, kjo ka pak rëndësi. Rëndësi ka që ne kemi realizuar kushte me këtë projekt, që sa të nisin investimet të vihet në zbatim pa kokëçarje të mëdha.


Ardit Bido

Hapësirat e reja çfarë risish do të sjellin në shërbim të ruajtjes dhe konservimit të arkivave?

-Projektet që u prezantuan kanë të bëjnë me dy komponentë. E para, që të mbyllet investimi madhor i qeverisë shqiptare mbi vendruajtjen në Shkozë, të bëhet dhe sistemi përreth dy godinave ekzistuese; gjë që e mbyll historinë e arkivave, jo vetëm të AQSHSH-së por edhe të arkivave të sistemit që e sistemojnë atë brenda të gjitha kushteve. E dyta, është me vlerë rikonstruksioni i kësaj godine;, një godinë e bukur e viteve '40, por që nga ana tjetër ka tre komponentë të rëndësishëm: e para bëhet më e qasshme për publikun, dhe një ambient më komod për studiuesin; e dyta ne arrijmë të krijomë edhe një muze arkivor. Ka edhe një rëndësi tjetër, sepse duhet të kujtojmë se ndonjëherë të huajt na shohin me një sy nënvleftësues në drejtim të historisë dhe kulturës që trashëgojmë, por nga ana tjetër, unë nuk kam parë asnjë të huaj që ka ardhur në arkivë e që s'ka dalë prej tij me habi të madhe dhe pa një vlerësim për trashëgiminë dhe kulturën e këtij vendi.

Meqë kujtuat të huajt, ka pasur interes prej tyre për kërkime në arkivat tona?

-Ka pasur interes. Ne tentojmë të nxisim pjesëmarrjen e tyre në arkiva. Jemi lidhur edhe me agjenci turistike që të vijnë ta shohin fillimisht arkivin. Nëse dikujt mund t'i duket Shqipëria një vend i prapambetur, një vend që nuk meriton të jetë europian e të tjera, pra ca paragjykime që janë "në modë" për ne, do të shoh këtu Kodikun e Beratit, etj, dhe ai do të ndryshojë opinionin për ne. Nëse vjen këtu dhe shikon se çfarë është ruajtur në shekuj, atëherë do kuptojë se ka të bëj me një komb të civilizuar. Jo pa krenari, të gjitha këto ne i kemi si vlera, por kjo mënyrë prezantimi është për t'iu thënë të tjerëve, se kemi shumë trashëgimi, dhe për këtë duhet të jemi ndoshta edhe pak egoistë, se ne jemi pjesë e një kombi të civilizuar që në kohërat më të hershme, dhe me një civilizim europian. Kështu që të mos e krijojnë atë përshtypje që kanë krijuar deri më sot për ne. Ne kemi krijuar këtë lloj dimensioni. Tani ne e bëjmë në mënyrë të sforcuar këtë gjë. Prandaj, një muze arkivor, ashtu siç duhet-perëndimor, do të ishte i hapur gjatë gjithë vitit për këdo. Pra në mënyrë identitare t'ua tregojmë të tjerëve se po flasim me një sivëlla, po aq europian sa ata...

Është përfolur shumë për zhdukje dhe cenime të materialeve Arkivës së Ministrisë së Brendshme. Çfarë është bërë për sigurimin e këtyre materialeve në Arkivën Qendrore të Shtetit?

-Kjo arkiv është ende në varësi të Ministrisë së Brendshme, ndoshta ndryshon në të ardhmen...



Pensionet e diplomatëve, si përfitohen dhe dokumentat

Fadil Kepi sqaron si përfitohen pensionet suplementare nga familjarët e diplomatëve dhe si llogariten

Në emisionin e mirënjohur "Këndi i Ekspertit" në Report TV, të drejtuar nga gazetarja Valbona Mhilli, në rubrikën "Pensioni im", si çdo javë ishte i ftuar eksperti i problematikave të pensioneve Prof. Dr. Fadil Kepi. Eksperti ynë ka folur këtë javë për pensionet e punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ai ka shpjeguar se si e përfitojnë diplomatët pensionin dhe se cili është dokumentacioni që u nevojitet për të. Gjithashtu profesor Fadil Kepi sqaron se si përfitohen pensionet suplementare nga familjarët e diplomatëve dhe si llogariten ato. Më pas eksperti ynë u është përgjigjur pyetje live nga qytetarët në Report TV për problematika të ndryshme që ata kanë rreth çështjeve të pensioneve.

Sot do të flasim për pensionet e punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Si e përfitojnë diplomatët pensionin? Cili është dokumentacioni që u nevojitet për pension? Si përfitohen pensionet suplementare dhe si llogariten?

Të gjithë personat, të cilët kanë kryer apo vazhdojnë të kryejnë funksione diplomatike, si ambasador, konsull, atashe, sekretar ambasade dhe punonjës të tjerë pranë ambasadave tona, paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore edhe për pension pleqërie edhe për pension suplementar. Nga rroga që ata marrin nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, 3%-5%, sipas funksioneve që ata kryejnë si funksionarë në ambasadat tona, u mbahen nga rroga për pensionet suplementare, përveç kontributeve që u mbahen për pensionet e pleqërisë.

Pasi këta persona mbarojnë së kryeri funksionet, në përgjithësi, ose përpara se të shkojnë ambasadorë apo në detyra të tjera, siç thashë, konsuj, atashe, këshilltarë në ambasada, punojnë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, pra, kualifikohen, përveç studimeve të larta që kanë kryer dhe gjuhëve të huaja që kanë mësuar.

Të gjitha këto shërbime apo funksione që ata kryejnë, përkthehen në pensione në të ardhmen?

Të gjitha këto vite shërbimi apo funksione, atyre u njihen si vjetërsi pune për pension sepse paguajnë dy lloje kontributesh. Mirëpo ka raste, kur burri emërohet ambasador dhe gruaja, detyrimisht, ndërpret punën e saj dhe e shoqëron atë. Ose ka raste kur gruaja është pa punë dhe e shoqëron bashkëshortin. Në këtë rast Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, do të paguajë kontributet e sigurimeve shoqërore edhe për bashkëshorten. Natyrisht që ajo nuk do të përfitojë pension suplementar sepse nuk kryen ndonjë funksion.

Po në rastin kur gruaja në Shqipëri ka qenë e papunësuar?

Përsëri Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 411, të vitit 2017, për ato gra që nuk kanë filluar punë ose që e kanë ndërprerë punën në momentin që largohen nga Shqipëria për të shoqëruar burrin, kontributet e sigurimeve shoqërore u paguhen mbi pagën minimale, e cila është 26.000 lekë të rinj. Këto pensione i cakton vetëm Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku është ngritur një drejtori e veçantë për pensionet suplementare.

Pensionet suplementare, bashkë me pensionet e zakonshme, kanë një kufi. P.sh., në qoftë se një punonjës e mbaroi detyrën si ambasador dhe kthehet të punojë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si inspektor i thjeshtë, i mbahen nga paga 1,1% kontribute për pension suplementar, përveç kontributeve për pensionin e zakonshëm. Në rast se personi është kryetar dege ose drejtor, atëherë i mbahet 1,3% e rrogës për pension suplementar. Në rast se është zëvendësministër, i mbahet 1,5% e rrogës. Ndërsa pozicioni i ministrit futet në rangjet më të larta. Në dy vitet e para të funksionit si ministër i mbahet 20% e pagës për pension suplementar etj.

Kur ndërpriten pensionet suplementare?

Pensionet suplementare ndërpriten vetëm në rastet kur vendos gjykata, me vendim të formës së prerë.

Por kemi edhe raste kur si ambasadore caktohet gruaja. Atëherë burri, nëse është pa punë, e shoqëron gruan në ambasadë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme duhet që t'i paguajë kontributet e sigurimeve shoqërore të paktën mbi pagën minimale që është 26.000 lekë të rinj. Në rast se burri ka punuar në Shqipëri dhe e ndërpret punën për të shoqëruar gruan, atëherë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të vazhdojë t'i paguajë kontributet e sigurimeve shoqërore mbi bazën e rrogës që ai merrte në momentin kur e ndërpreu punën.

Jam një qytetare nga Elbasani. Jam 67 vjeçe. Kam punuar në shtypshkronjë, me plumb, në linotyp. Meqë punoja në profesion të vështirë, kam dalë në pension të parakohshëm, me 60%. Kisha 23 vite pune. Pastaj e fillova sërish punën sepse ndërmarrja u kthye në aktivitet privat dhe kam paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2003. U shkëputa nga puna në vitin 2007, kur mbusha moshën dhe mora pensionin e plotë. A e përfitojshtesën prej 20%, që qeveria e ka vendosur tani?

Jo, zonjë, nuk e përfitoni. Arsyeja është se sipas ligjit, i cili është miratuar në datën 23 maj dhe që ka shkuar për t'u dekretuar te Presidenti i Republikës, dhe pritet që të dalë në "Fletoren Zyrtare" gjatë këtyre ditëve dhe që do të hyjë në fuqi në muajin shtator, pra 3 muaj pasi e firmos Presidenti, nuk do ta përfitojnë shtesën as minatorët e tokës, as punëtorët e naftës dhe të gazit, as punëtorët e metalurgjisë. Por do të hyjë në fuqi pas 3 muajve. Në një pikë të veçantë të këtij ligji thuhet se pension suplementar do të përfitojnë vetëm këto tri kategori punonjësish dhe asnjë kategori tjetër. Mos mbaj shpresë. Asnjë fjalë nuk thuhet në "Fletoren Zyrtare" për pensionet suplementare të këtyre tri kategorive: të minatorëve të nëntokës, punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit, dhe ata që kanë punuar në metalurgji në punë të vështira, të kategorisë së parë. Pra, edhe këtyre kategorive do t'u jepet pensioni suplementar në muajin shtator, 3 muaj pasi e dekreton Presidenti i Republikës. Kjo ndodh sepse Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në mënyrë intensive, me specialistët më të mirë që ka, duke bashkëpunuar edhe me speecialistët përkatës të industrisë së naftës e të gazit, dhe duke bashkëbiseduar edhe me specialistët e metalurgjisë së zezë, janë duke hartuar listat se kush do të përfitojë nga ky ligj. Do të përfitojnë, në radhë të parë, të gjithë ata që kanë punuar në minierë nën tokë dhe që kanë dalë në pension, pavarësisht se kur kanë dalë në pension. Edhe profesioni në të cilin ka punuar zonja është profesion i vështirë, por nuk përfshihet në këtë ligj dhe nuk trajtohet me pension suplementar.

Jam nga Kukësi. Jam 54 vjeç. Kam punuar 11 vite nën tokë. Nuk kam paguar asnjë lloj siguracioni. Tani trajtohem me ndihmë ekonomike. A do të marr pension?

Minatorët e nëntokës ndahen në dy kategori. Minatorët e nëntokës të cilët kanë dalë me trajtim të veçantë në vitin 2000, sipas Ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000, deri më 31 dhjetor të vitit 2001. Ky ligj ka qenë në fuqi 4 muaj e gjysmë. Nga data 6 nëntor 2014 kanë dalë në pension 55 vjeç, kur kishin gjithsej 30 vite punë, përfshirë këtu edhe vitet e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, edhe periudhën e trajtimit me asistencë, dhe nga të gjitha këto vite, 11 vite e gjysmë duhej të kishin punuar nën tokë. Zotëria ka 11 vite punë në nëntokë. Të paktën duhet të ketë 12 vite e gjysmë sepse zotëria nuk ka dalë në trajtim të veçantë si minator i nëntokës, në vitin 2000, nga 9 nëntori 2000 deri më 31 mars 2001. Me të dhënat që na tha zotëria, ai del në pension në moshën 65 vjeç, as edhe 1 ditë më parë, ose duhet që të punë edhe 1 vit e gjysmë nën tokë. Ditën që do të plotësojë 12 vite e gjysmë punë nën tokë dhe ka moshën 55 vjeç, dhe gjithsej ka 30 vite punë, atëherë del në pension si minator i nëntokës. Sqarime të hollësishme zotëria mund të marrë edhe në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Kukës.

Jam nga Lezha. Unë jam invalid i grupit të dytë që nga viti 2002 dhe jam 59 vjeç. A më quhen si vjetërsi pune për pension vitet e trajtimit me pension invaliditeti dhe a përfitoj nga ligji i ri?

Zotëria do të dalë në pension në moshën 65 vjeç, pra në vitin 2025. Vitet gjatë të cilave ai është trajtuar me pension invaliditeti, do t'i njihen si vjetërsi pune për pensionin e pleqërisë, sipas nenit 58 të Ligjit për Sigurimet Shoqërore. Në rast se mosha 65 vjeç, zotërinë do ta gjejë si invalid, atëherë ai do të vazhdojë të marrë pagesën prej 3.300 lekësh të rinj nga Bashkia, por do të zgjedhë për të marrë ose pensionin e invaliditetit ose pensionin e pleqërisë, cili do t'i leverdisë më shumë, pra cili do t'i dalë më i lartë. Gjithashtu do të përfitojë falas edhe barnat mjekësore të rimbursueshme qoftë si invalid, qoftë si pensionist. Por, nëse zotëri nuk është sqaruar, atëherë ai mund të marrë sqarime më të hollësishme në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Lezhë.

Flas nga fshatrat e Fierit. Jam 41 vjeç. Kam filluar të paguaj kontributin e sigurimeve shoqërore për pension që para 15-16 vitesh. Në fillim pagesa ka qenë më e ulët dhe tani është rritur. Si do të vlerësohet pensioni?

Zotëria ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore si i vetëpunësuar në bujqësi. Është e vërtetë që fillimisht vlera e kontributeve ka qenë më e ulët. Tani, krahas me rritjen e indeksimit të pensioneve, shtohet edhe pagesa e kontributeve. Aktualisht për zonat malore është 29.400 lekë ose 80 lekë në ditë, sa një kafe. Ndërsa për zonat fushore ku hyn edhe Fieri vlera është 38.400 lekë. Sqarime më të hollësishme zotëria duhet të marrë në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Fier.

Paradë
FJALËKRYQESH



NGA KADRI VOKOPOLA

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI **33** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL
1. Në hyrje të apartamentit.
-Kush nuk ka... nuk pret
-Clark, alias Superman.
-Tayler aktore
2. Janë kabina në anije
-Rafaeli top model.
-Humb në kufij.
-Fillojnë hollësitë.
3. Nuk tuten.
-Një është edhe Korabi.
-Skuadra merengue.
4. Mund të kthehe në mllefe.
-Janë njerëzit që nuk shpërdorojnë energji.
5. Është fjala që duhet thënë.
-Janë eprorët për vartësit.
6. Moore aktore.
-Nganjëherë i mbajnë sekret trainerët.
7. Italia në tabela.
-Marie dy herë nobeliste.
-Një gëzim i amdh.
8. Larg në kufij
-Ines aktore.
-Kush i ka... fërgëllon.
9. I katërti në kaptiull.
-Janë thirrur nën armë.
-Roman pa fillim e pa fund.
10. Qyteti i Turgeniev.
-Qendër më kaos.
-Janë në mes.
-Është porosia e fundit.
11. Provinca e boerëve.
-Ora këngëtare.
-Është shejtani.
12. Ishin bijtë e të shtatëve kundër Tebës.
-Premtojnë të bëhen kampionë.

VERTIKAL
1. Një pjesë e operas.
-Janë emisionet e lajmeve.
2. Janë principe.
-Një pele është proverbial.
3. Një... art i Don Judd.
-Hetim pa kufij.
4. Kujti kërcen... xhindoset.
-Arkipelagu i Solzhenitcin.
5. Është prifti.
-Kështu fillon loja.
6. Mund të prishin kohën.
-Magnetike ajo e Oersted.
7. Në fund të vitit.
-Janë ata qe dinë të flasin.
8. Paralajmërojnë thyerje.
-Në fund të fundit.
9. Treguojnë kohë të mirë dhe të keqe.
10. Është fëmija.
-Ashti si s'rri zevzeku.
11. Inicialet e Rohmer.
-Një pagesë për avokatin.
12. Kujtohet me nostalgji në pleqëri.
-Halle pa kufij
13. Dreiser që shkroi Një tragjedi amerikane.
-Vanessa violiniste.
14. Janë fruta ekzotikë.
-Margret aktore.
15. Diane aktore.
-Janë gremina.
16. Inicialet e Holm aktor.
-Lutet pa çifte.
-Është budallaçka.
17. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
-Shteti i francezëve

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

A	S	I	A	■	A	F	R	E	S	K	■	D	I	T	A	R
S	H	P	R	E	H	J	E	■	P	■	D	I	T	A	■	R
T	I	T	A	N	E	■	P	H	I	L	O	V	A	N	C	E
R	U	■	■	O	■	T	A	U	R	O	M	A	K	I	A	■
O	■	P	A	■	M	A	R	G	A	R	I	T	A	■	N	M
■	D	O	N	B	A	R	T	O	L	O	■	■	■	E	T	I
A	■	S	T	A	R	T	■	B	E	K	I	M	■	L	O	N
P	A	T	E	N	T	A	■	O	T	O	■	■	L	I	N	A
■	D	A	N	D	I	N	■	S	■	V	S	■	A	G	A	R
D	E	R	A	I	N	■	F	S	H	A	T	A	R	E	■	E
O	L	■	■	T	■	S	I	■	E	Ç	A	R	E	■	A	T
P	E	N	G	E	S	A	T	■	D	I	N	A	S	T	Y	■

HOROSKOPI

DASHI
Neptuni do ju ndihmoje pafundësisht ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Ai do ua beje idetë me te qarta dhe do arrini te merrni vendime te rëndësishme. Beqaret do kenë shume fantazi, por ne fakt realiteti nuk do jete i njëjtë. Sa me shume te ëndërrojnë aq me shume do mërziten. Saturni do favorizoje ndjeshëm financat. Do jeni me te logjikshëm me shpenzimet dhe me menaxhimin dhe nuk do keni probleme.

DEMI
Nëse keni një lidhje sot me ne fund do ndiheni plotësisht te lumtur ne krahët e partnerit. Ai nuk do reshte se ua shprehuri ndjenjat dhe do ju surprizojë here pas here. Beqaret gjithashtu do favorizohen, po nuk duhet te nxitohen për asgjë. Me mire t'i hedhin hapat një e nga një. Sektori i financave do varet tërësisht nga mënyra sesi ju do i menaxhoni te ardhurat qe do keni.

BINJAKET
Do prisni shume nga kjo ditë ju te dashuruarit, por ne fakt gjerat nuk kane për t'iu ecur si duhet. Shpesh do futeni ne debate te kota me partnerin dhe do thoni fjale te gabuara. Beqaret do realizojnë një takim vendimtar qe do ua turbulloje tërësisht jetën. Shume gjerat do jene ndryshe për ta. Ne planin financiar do keni plot mundësi për ta përmirësuar situatën, por duhet t'i shfrytëzoni ato.

GAFORRJA
Dite shume e bukur ka për te qene kjo e sotmja për ju te dashuruarit. Do ndiheni mire ne çdo moment me partnerin dhe do ja shprehni atij pafund ndjenjat. Beqaret do marrin deklarata te forta dashurie dhe zemra do ju ngrihet peshe. Nëse do duan vete ata mund ta ndryshojnë statusin menjëherë. Ne planin financiar Merkuri do ju beje me inteligjente. Do dini mire si t'i mbroni te ardhurat qe do keni.

LUANI
Sot me ne fund do arrini te afroheni me shume me partnerin tuaj dhe marrëdhënia me te do ece ne rrugën e duhur. Nuk do keni me pretendimet e dikurshme. Beqaret mire është te tregohen vigjilente sepse ne te kundërt mund te përballen me zhgënjime te mëdha. Ne planin financiar tregohuni gjithë kohës te vëmendshëm nëse nuk doni te përballeni me surpriza te këqija.

VIRGJERESHA
Pas një periudhe jo fort te favorshme, sot me ne fund do arrini te zgjidhni te gjitha problemet qe keni pasur me partnerin dhe do ndiheni me te qete. Beqaret ka shume mundësi te afrohen edhe me shume me shpirtin e tyre binjak dhe jeta do ju marre një drejtim krejt ndryshe. Situata financiare nuk do jete shume e qëndrueshme kështu qe me mire shpenzoni me kursim.

PESHORJA
Jeta juaj ne çift do ece si duhet sot dhe nuk do keni me debate apo acarim. Do jeni shume me te logjikshëm dhe madje do kërkoni falje për gabimet e bëra. Beqaret ka mundësi te fillojnë te ndiejnë për disa persona qe i kane njohur pak kohe me pare dhe qe i kane miq. Financat do jene goxha me te mira fale ndikimit te Merkurit. Do ju duhet thjesht te mos merrni vendime te nxituara.

AKREPI
Do keni besim te verbër tek partneri juaj sot dhe për fat te mire ai nuk do ju zhgënjejë. Çdo moment kur te jeni pranë njeri-tjetrit do jete si një përrallë. Beqaret do ndihmohen nga disa miq te rinj dhe do e gjejnë personin me te përshtatshëm. Nëse me shpenzimet tregoheni te matur, gjendja e financave ka për te mbetur e mire. Ne te kundërt përgatituni për tronditje.

SHIGJETARI
Sot do reflektoni me kujdes ju te dashuruarit dhe do e kuptoni qe duhet te bëni me tepër për te mbajtur zgjuar zjarrin e pasionit. Vetëm ne këtë mënyrë marrëdhënia ne çift do përmirësohet aq sa keni ëndërruar. Beqaret gjithashtu do i kenë te gjitha mundësitë për te realizuar takimet e ëndërruara. Me financat nuk do keni asnjë lloj problemi kështu qe mund te bëni edhe investime.

BRICJAPI
Sot do kaloni plot momente te lumtura ju te dashuruarit sepse si ju ashtu edhe ai qe keni ne krah do mendoni për surpriza dhe do ja shprehni ndjenjat njeri-tjetrit. Beqaret duhet ta lënë veten te lire dhe kane për te gjetur personin e tyre te ëndrrave. Ne planin financiar duhet te tregoheni disi me te kujdesshëm se me pare pasi gjendja nuk do jete aq e mira sa do donit.

UJORI
Yjet nuk do e favorizojnë aspak jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite kështu qe duhet te jeni te kujdesshëm me çdo hap qe do hidhni ne mënyrë qe te mos keni probleme. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare ne momentin qe me pak do e presin. Financat nuk do jene ne një gjendje te mira. Shpenzoni me kursim e maturi nëse nuk doni te mbeteni me duart bosh.

PESHQIT
Dite mjaft premtuese do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do kaloni pafund momente te këndshme me partnerin dhe ne fytyrën tuaj nuk do venitet asnjë çast buzëqeshja. Beqaret nuk duhet te tentojnë te shkatërrojnë një lidhje tjetër vetëm për te pasur pranë dike qe pëlqejnë. Ne planin financiar Plutoni do ju nxite te jeni me te organizuar dhe me kursimtare.

SUDOKU


PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

6		1	2			7	4	8
5	7	4			8		3	
3				9			6	1
	4			1				7
		7	8		9	4		
8				7			9	
1	8			4				3
	5		9			6	2	4
4	6	9			3	1		5

PËRGJIGJE

2	3	6	8	7	4	5	9	1
8	1	5	6	3	9	2	4	7
4	9	7	1	5	2	3	8	6
9	6	4	7	8	5	1	3	2
5	2	3	4	9	1	7	6	8
7	8	1	2	6	3	9	5	4
3	4	2	5	1	6	8	7	9
1	7	9	3	4	8	6	2	5
6	5	8	9	2	7	4	1	3


FJALËKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL
1. ... Kun Agüero.
3. Kufizojnë mendimin.
6. I ka të ndryshme plaka
8. Roberto trainer italian
11. Është skuadra gigliata në Itali.
13. Igli Tare.
14. Është mbrojtës grek
16. Inicialet e Messi-t
17. Një skuadër e Düsseldorf.
18. Një luhet nga aktori
19. Gjysmë fjalie
21. Është dimensioni.
22. Lumi i Bernës
23. Është një send
25. Inicialet e Asimov.
26. Kufizojnë gabimet.
28. Fillojnë testin
30. As unë as ti
31. Në krye të radhës
33. Futblollisti në foto
39. Futbollisti në foto

VERTIKAL
1. Janë të mëdha ato të kinematë.
2. Mund të bëjnë stil të lirë
3. Gabbiadini futbollist
4. Një thirrje e patrullës
5. Një mund të jetë fetar
6. Ka tetë korsi.
7. Është quajtur "Ferrari" e Anglisë.
8. Dënim pa zanore
9. El... siç thirret Fernando Torres
10. Bëhet në start
11. Ruhet ajo sportive.
12. Ente Sportive Autonome
14. Bëhet me shumë zëra.
15. Gjysma e afatit
16. Pak lagështirë
17. Kështu fillon festa
20. Mbyllin një sirtar
21. Kështu fillon periudha
24. Mario mesfushor portugez
26. Buffon portier
27. Ana e mprehtë e thikës
28. Njën pjesëz për bashkë
29. Luarasi aktore
30. Gjysmë armate
31. Gjysmë rehati
32. Janë në fazë
33. Jetoj në kufij
34. Kufijtë e mendjes
35. Në krye të subjekteve
36. Rastisur në krye
37. Roberto Mancini
38. Në mes të këpucëve

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV



FJALEKËRYQI I KRIPTOGRAFUAR

8	3	1	5	■	13	■	18 V	9	■	6	9	13
19	■	18	6	7	1	3	8 E	■	8	5	1	6
7	6	■	12	2	9	2	5 L	8	5	8	■	7
1	■	7	2	9	1	14	2 A	7	1	■	13	1
■	14	2	7	1	5	1	■	11	■	4	2	3
■	4	14	2	15	2	19	16	8	9	■	13	8
11	2	■	7	2	7	2	■	7	2	18	2	7
8	3	7	■	7	■	7	2	■	4	5	■	■
5	1	9	2	■	1	■	18	■	7	6	14	8
8	5	8	3	8	19	7	2	9	8	■	9	16
19	1	18	8	5	8	7	■	8	4	3	8	9
2	■	2	19	2	4	7	2	4	1	2	■	2

PËRGJIGJE

B	I	M	A	■	P	E	S	H	O	R	E	■	■	■
A	G	I	■	H	■	M	■	A	M	A	R	O	■	■
S	■	C	H	E	V	R	O	L	E	T	■	B	■	■
■	C	H	A	R	L	E	S	■	L	■	M	I	■	■
H	I	E	N	A	■	■	E	V	I	T	A	■	■	■
■	K	L	I	K	A	■	■	K	A	I	N	I	■	■
■	L	E	B	L	A	N	C	■	■	M	U	R	■	■
T	E	■	A	I	■	I	H	■	S	P	A	M	■	■
■	T	O	L	T	E	K	E	■	H	A	L	A	■	■
P	■	M	I	I	■	O	R	G	A	N	E	■	■	■
U	M	A	■	■	M	N	■	■	A	M	I	T	A	■
B	A	R	R	I	E	■	U	N	I	■	■	■	N	■

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

Alba MALLTEZI **DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP ;** Aurel PEPA ***KRYEREDAKTOR***
Patricia COSTANTINESCU ***ADMINISTRATORE E PËRGJITHSHME*** ; Admirina PEÇI ***KRYEREDAKTORE E "RILINDASI" ;***
LAYOUT DESIGN : Altin ALIAJ, ***SHPËRNDARJA:*** Spiro MESHINI ***CEL:*** +355696088847
Departamenti i Marketingut: Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419 - ***marketing@shqiptarja.com***
Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. ***E mail:*** shqiptarja.com@hotmail.com ***Website:*** www.shqiptarja.com ***Mobile:*** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

VOTO !
TI VENDOS !

ZGJEDHJE PËR
ORGANET E QEVERISJES
VENDORE 2019



Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet.
Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë, ndaj më shumë se një zgjedhësi apo kur kryhet nga komisionerët zgjedhorë dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet.

Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor, në kundërshtim me ligjin, i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor dënohet me burgim nga 6 muaj deri 5 vjet.

Qëndrat e votimit hapen në orën **07:00**
dhe mbyllen në orën **19:00**
Ju mund të votoni me **letërnjoftim**
ose me **pasaportë**

Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:
www.cec.org.al

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE • TIRANE •


VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!

BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War

Ku ndodhet BUNK'ART 1?
Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë



ORARI: 09:00 - 16:00
të hënë & të martë pushim

BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror

Ku ndodhet BUNK'ART 2?
Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë



ORARI: 09:00 - 18:00
çdo ditë

www.bunkart.al
info@bunkart.al

PRENONTIME
RESERVATIONS:
+355 (0) 67 20 72 905